

1 E hënë, 24 mars 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.02

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e
6 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Për procesverbal, vërej që të katër të akuzuarit janë të
13 pranishëm në sallën e gjyqit.

14 Përpara se të vijë dëshmitari, ka disa aspekte paraprake
15 që dëshiroj të trajtojme.

16 Së pari, Trupi Gjykses do të marrë vendim lidhur me
17 pranimin audio-video të Dëshmitarit W04264, është deklarata e
18 dëshmitarit që është kërkuar të pranohet nga ZPS-ja në
19 parashtrimin e protokolluar F02964 dhe Mbrojtja nuk është
20 përgjigjur për këtë.

21 Ne mendojmë se janë të pranueshme deklaratat e
22 Dëshmitarit W04264 në bazë të rregullave 138 dhe 155, dhe
23 Trupi Gjykses për rrjedhojë i pranon si prova gjyqësore këto
24 materiale siç është përmendur në Shtojcën numër 1 të
25 parashtrimit të protokolluar F02964, dhe udhëzojmë Zyrën

1 Administrative që t'i japi incizimit audio-video të njëjtin
2 numër prove që i është dhënë dhe deklaratës përkatëse siç
3 është përmendur në Shtojcën numër 1 të parashtimit të
4 protokolluar F02964.

5 Më tej i kërkojmë ZPS-së të bëjë parashtime sa i takon
6 klasifikimit të incizimit audio-video.

7 Z. Prokuror, ju lutem a mund të na e thoni tani çfarë
8 klasifikimi do të ketë?

9 Z. PACE: [Përkthim] Do t'ua konfirmojë pak më vonë këtë,
10 ju lutem.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Gjithashtu, do t'i japim fjalën tani Mbrojtjes së z.
13 Thaçi që të bëjë parashtime siç kanë kërkuar përmes postës
14 elektronike.

15 Duhet të kalojmë në seancë private për këtë, z. Misetic?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, fillimisht
17 Prokuroria kishte një mocion për shtimin e provave dhe më
18 pastaj mund t'i përgjigjem unë që të trajtojë dhe pjesën e
19 mocionit. Do të ishte më efikase kështu.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

21 Kalojmë në seancë private.

22 [Seancë private]

23 [Seancë private teksti i fshirë]

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kemi kaluar në seancë
16 publike.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
18 dalim nga salla dhe ka rëndësi me atë që po thuhej tani, ky
19 dëshmitar, mua më duket se mund të vazhdojë deri nesër edhe
20 përfshirë edhe kundërpyetjet.

21 Z. PACE: [Përkthim] Po e kemi rishikuar, e kemi çmuar
22 deri në katër orë. Kështu që po duket se pyetjet nga Mbrojtja
23 do të fillojnë nesër.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E dyta, kemi
25 ndonjë dëshmitar për javës tjetër?

1 Z. PACE: [Përkthim] Kemi një dëshmitar tjetër për këtë
2 javë.

3 Për javën tjetër kemi një dëshmitar të njoftuar që është
4 parashikuar për të martën, se e hëna është ditë pushimi dhe më
5 thonë që takimi për të martën nuk mund të zhvendoset. Por ne
6 gjithsesi synojmë që të jemi këtu të martën për të marrë në
7 pyetje dëshmitarin. Dhe ky është dëshmitar i vetëm në bazë të
8 njoftimit për javën tjetër.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të dalim
10 nga salla një kohë të shkurtër.

11 --- Seanca ndërpritet në orën 09.41

12 --- Seanca rifillon në orën 09.57

13 Z. PACE: [Përkthim] Nëse mund t'ju përditësoj për pyetjen
14 që më bëtë përpara pushimit lidhur me konfidencialitetin.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast, ju
16 lutem.

17 Po, mund të vazhdoni, z, Pace.

18 Z. PACE: [Përkthim] Kjo nuk ka lidhje me çështjen që u
19 diskutua përpara pushimit. Sot në mëngjes pyetët nëse audio-
20 video ka - 4264, çfarë klasifikimi duhet të ketë. Lidhur me
21 këtë unë thashë që Pjesa e 1-rë duhet të jetë konfidenciale.
22 Në parashtrimin tonë kjo përputhet me kërkesat që kemi bërë me
23 postë elektronike në mënyrë që klasifikimi prej deklaratës
24 sipas rregullës 155, sipas emailit të datës 20 janar 2025.

25 Pra, edhe transkripti edhe video, vetëm Pjesa e 1-rë,

1 duhet të jetë konfidenciale, pjesa tjetër mund të jetë
2 publike.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
4 Kështu e japim dhe urdhrin. Në rregull atëherë. Sa i takon
5 asaj për të cilën po flisnim, z. Misetic, do t'ju japim kohë
6 për t'u takuar me klientin. Të gjithë ju, faktikisht, mund të
7 keni kohë të takoheni me klientët deri në orën 2.30.

8 Sot dokumenti që referohet si artikulli në gazetën Kombi
9 nuk do të shtohet në listën e provave materiale. Është -- ka
10 një problem me faktin që nuk është parashikuar në kohën e
11 duhur. Ka një problem me arsye të qenësishme sa i takon mos-
12 hetimit plotësisht nga ZPS-ja të këtij artikulli për të cilën
13 ato kanë dhënë njoftim.

14 Në për -- ne do të rrëzojmë kundërshtimin për çështjet
15 orient -- sugjestionuese në paragrafin 12 dhe 63, pra, mund të
16 bëhen pyetje për këtë çështje nga ZPS-ja.

17 Në fund, sa i takon provave të tjera materiale, përveç
18 artikullit në gazetën Kombi, ato mund të shtohen. Këtu do të
19 bëjmë ndërprerjen e seancës deri në orën 2.30 Dhe nëse ka
20 ndonjë problem që lind, z. Misetic, ju lutem -- po, më falni,
21 të mbaroj një herë. Të përfundoj fjalinë time. Pra, na
22 informoni për ndonjë problem që të mund të lindtë dhe do ta
23 trajtojmë, por hë për hë kjo është.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju kuptova. Në rregull.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, z. Laws.

1 Z. LAWS: [Përkthim] ju kërkoj leje Trupit Gjykues t'i
2 kundërpërgjigjem një parashtrimi të protokolluar të ditës së
3 premtë.

4 Më datë 11 mars Trupi Gjykues kërkoj parashtrime nga
5 Mbrojtësi i Viktimave lidhur me komentet e ZPS-së lidhur me
6 kushtet e paraburgimit. Në përgjigje të atij emaili është
7 caktuar një afat për përgjigje nga Mbrojtja, dhe parashikoj që
8 nuk do të kishte kundërpërgjigje, prandaj dhe parashtrimi im.
9 Kërkoj leje nga Trupi Gjykues për të bërë kundërpërgjigje.

10 Ne kemi dorëzuar me 18 mars, dhe Mbrojtja e Selimit dhe
11 Mbrojtja e Veselit kanë dorëzuar përgjigje të premtën që
12 shkoi, me 21 mars.

13 Ne dëshirojmë të kundërpërgjigjemi vetëm përgjigjes së
14 Mbrojtjes së z. Veseli, e cila duket se thotë diçka të pasaktë
15 lidhur me parashtrimin tonë të protokolluar, e cila për ne ka
16 një farë rëndësie. Nëse jepet leje që të dorëzojmë një
17 kundërpërgjigje, ju them se do jetë më pak se 200 fjalë e
18 gjatë kjo kundërpërgjigje dhe do të dorëzohet sot.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
20 kundërshtim nga Mbrojtja e Veselit?

21 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk e di se ku qëndron problemi për
22 çfarë pasaktësie pretendohet, por nuk kemi kundërshtim nëse
23 mbetet vetëm për këtë pikë kjo kundërpërgjigje.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po këtë po
25 thotë edhe z. Laws.

1 Mbase një diskutim ndër palëve do të ishte i dobishëm,
2 por ju e keni lejen për kundërpërgjigjet.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

4 --- Seanca ndërpritet në orën 10.03

5 --- Seanca rifillon në orën 12.15

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
7 fillojmë më dëshmitarin kemi një urdhër me gojë për ta dhënë
8 tani.

9 Trupi Gjykses vëren se në parashttrimin e protokolluar
10 F03045, ZPS-ja ka kërkuar leje për të ndryshuar listën e
11 provave materiale për t'u shtuar shtatë -- më falni - më
12 falni, e lexova këtë urdhër më duket. Jo, më falni. Ju kërkoj
13 ndjesë e lexova këtë urdhër më herët.

14 Në rregull, atëherë. Le të vijë dëshmitari në sallë.

15 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, a
17 na dëgjon?

18 DËSHMITARI: Po.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë mirë.
20 Dëshmitar, Sekretarja e Gjykatës do të të japi betimin solemn
21 tani të cilin duhet ta lexoni në përputhje me Rregulloren e
22 Procedurës dhe të Provave. Ju lutem, tekstin lexojeni me lë të
23 lartë.

24 DËSHMITARI: Betimi solemn: Sipas Rregullores 141(2): I
25 ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë

1 time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën,
2 krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të
3 fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

4 DËSHMITARI: NAIM MALOKU.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
6 Tani mund të uleni.

7 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që
8 mendohet të zgjasë përafërsisht dy ditë. Sikurse mund ta dini,
9 fillimisht i bën pyetjet Prokuroria. Pasi të përfundojë
10 Prokuroria ekipet e Mbrojtjes kanë të drejtë t'ju bëjnë
11 pyetje, por pyetje mund të kenë dhe Gjykatësit e Panelit.

12 Prokuroria ka parashikuar dy orë për pyetjet e veta.

13 Apo më duket sikur thatë katër orë, z. Pace, apo jo?

14 Z. PACE: [Përkthim] Po.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra,
16 Prokuroria do t'ju bëjë pyetje katër orë, ekipet e Mbrojtjes
17 kanë kërkuar deri në dhjetë orë të gjitha së bashku. Inkurajoj
18 palët të jenë sa më të kujdesshme në shfrytëzimin e kohës.
19 Trupi Gjykses mund të lejojë pyetje plotësuese nëse përmbushen
20 kushtet përkatëse.

21 Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni qartë, me fjali të
22 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkon që
23 pyetja të përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që
24 ta sqarojmë. Gjithashtu, ju lutem, na thoni ku i bazoni ju
25 faktet, rrethanat për të cilët do t'ju bëjnë pyetje. Në qoftë

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 29

1 se Prokuroria ju kërkon të përmendni korrigjimet që i keni
2 bërë deklaratave të mëparshme, ju duhet të thoni me zë për
3 procesverbal që deklarata me shkrim, bashkë me korrigjimet
4 përkatëse pasqyron saktësisht deklaratën tuaj.

5 Flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara
6 se të përgjigjeni, dhe ju lutem flisni ngadalë për
7 përkthyesit.

8 Gjatë kohës që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit, nuk
9 duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
10 jashtë Gjykatës. Në qoftë se dikush jashtë Gjykatës ju bën
11 pyetje për dëshminë tuaj, ju lutem na informoni.

12 Ju lutem ndërpriteni fjalën nëse jua kërkoj unë dhe ju
13 lutem mos flisni më në qoftë se më shini që unë ngre dorën,
14 sepse kjo do të thotë që unë duhet t'ju jap një udhëzim.

15 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, na thoni dhe do
16 të bëjmë organizimin përkatës.

17 Mirë, fillojmë tani me pyetje nga Zyra e Prokurorit të
18 Specializuar që janë ulur në të majtën tuaj. Ju lutem
19 dëgjojeni me vëmendje.

20 Z. Pace, fjala është për ju.

21 Pyetje nga z. Pace:

22 Z. PACE: [Përkthim]

23 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Ne jemi takuar bashkë më përpara,
24 por për t'u prezantuar dhe një herë, unë quhem James Pace dhe
25 jam Prokuror pranë Prokurorisë. Dhe unë do të jem Prokurori që

1 do t'ju bëj pyetjet për katër orët në vijim.

2 Ju lutem a mund të na thoni emrin dhe mbiemrin.

3 PË. Jam Naim Maloku.

4 PY. Datëlindja e juaj cila është?

5 PË. 17.02.1958.

6 PY. Ku keni lindur?

7 PË. Në fshatin Llabjan, komuna e Pejës, Kosovë.

8 PY. A ju kujtohet që të keni dhënë një intervistë për ish-

9 Tribunalin e Hagës në vitin 2005?

10 PË. Më kujtohet, ka qenë para 20 vjetëve.

11 PY. A ju kujtohet që keni marrë pjesë edhe në një seancë të

12 Speciales së Kosovës për një çështje të vitit 2011, në vitin

13 2011 - më falni?

14 PË. Po, kam dëshmu nën betim në Gjykatë në Gjakovë.

15 PY. A ju kujtohet që keni marrë pjesë në një intervistë të --

16 po ashtu të Prokurorisë Speciale të Kosovës në 2016?

17 PË. Po -- të Kosovës? Më falni?

18 PY. Po, Prokuroria Speciale e Kosovës.

19 PË. Po.

20 PY. A ju kujtohet të keni marrë pjesë në një intervistë me

21 Prokurorinë këtu në 2019-n, por në një shtet tjetër?

22 PË. Po. Në shtetin ku jeton unë, në Slloveni.

23 PY. A është e vërtetë që javët e fundit ju kemi lexuar

24 transkriptet me shkrim edhe procesverbalet e intervistave që

25 keni dhënë përpara, dhe a ju dhamë ne mundësinë t'i rishikonit

1 dhe një herë për të bërë korrigjimet përkatëse?

2 PË. Po, e vërtetë.

3 PY. A ju kujtohet që bëtë disa korrigjime dhe disa sqarime?

4 PË. Po, e vërtetë.

5 PY. A e mbani mend që këto sqarimet dhe korrigjimet ne i

6 hodhëm në një shënim dhe më pas ja u lexuam ju sërish

7 shënimin?

8 PY. Po, më kujtohet.

9 PY. Tani duke marrë parasysh korrigjimet dhe sqarimet që u

10 hodhën në atë shënim, përmbajtja e deklaratave dhe

11 transkriptove që përmenda unë, a është e saktë dhe e vërtetë

12 me sa keni ju dijeni dhe me aq sa besoni ju?

13 PË. Jam munduar me qenë i saktë.

14 PY. Duke marrë parasysh korrigjimet që u hodhën në atë

15 shënim, deklarata dhe transkriptet që përmenda unë, a

16 pasqyrojnë saktësisht atë që do të thonit sërish ju sot nëse

17 do t'ju bënim pyetje për të njëjta ngjarje që përmbajnë këto

18 deklarata?

19 PË. Mendoj që do t'ju përmbahem atyne.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin

21 e deklaratës së mëparshme -- deklaratave të mëparshme - më

22 falni - dhe një prove materiale shoqëruese. Bëhet fjalë për

23 materialet që ne i kemi përmendur në Shënimin F02913. Edhe

24 numrat përkatës mund t'i gjeni në Shtojcën 1 të Shënimit

25 Përgatitor numër 1, që po ashtu kërkojmë të pranohet bashkë me

1 deklaratat dhe përkatësisht mban numrin 126641-126649.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

3 kundërshtime

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

5 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

7 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

9 Materialet e numërtuara pranohen dhe do të marrin numrin
10 përkatës.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ta bëj tani për
12 procesverbal?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ta them tani për
15 procesverbal, më falni.

16 Materiali i parë mban numrin e ERN-së T002976-TR-ET edhe
17 shqipja do të marri numrin e provës P02087.1.

18 Materiali T000-2976-TR-ET Pjesa 2 dhe shqipja do të
19 marrin numrin e provës P02087.2.

20 T000-2976-TR-ET Pjesa 1_Korrigjim i Përkthyer dhe shqipja
21 do të marrin numrin e provës P02087.3

22 Materiali tjetër SPOE00070682 deri në SPOE00070798 [Sipas
23 përkthimit] me sa kuptoj unë keni kërkuar të pranohet vetëm
24 numri i faqes -- faqet me numrin 70685?

25 Z. PACE: [Përkthim] Për mendimin tim, pranoheni të

1 gjithën me një numër sepse i vetmi dallim është ndarja në
2 anglisht dhe në shqip.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit për
4 sqarimin. Atëherë i gjithë materiali SPOE007062-SPOE0070698
5 [Sipas përkthimit] pranohet dhe merr numrin e provës P02088.

6 Materiali SPOE0067215 [Sipas përkthimit] deri në
7 SPOE00067221 RED dhe përkthimi në anglisht do të marrë numrin
8 e provës P0089 [Sipas përkthimit].

9 ERN-ja 064883 [Sipas përkthimit] deri në 064886 RED që
10 është në sllovenisht, dhe ka një përkthim në anglisht dhe në
11 shqip po ashtu pranohet dhe merr numrin e provës P02090.1.

12 Materiali 064887-TR-ET Pjesa 1 dhe përkthimi në gjuhën
13 shqipe do të marrë numrin e provës P02090.2.

14 Materiali 064887-TR-ET dhe përkthimi në shqip, Pjesa 2,
15 merr numrin e provës P02090.3.

16 Materiali 064887-TR-ET Pjesa 3 dhe përkthimi në gjuhën
17 shqipe do të marrë numrin e provës P02 -- 02, më falni, 094.4
18 [Sipas përkthimit].

19 064888-TR-ET Pjesa 1 dhe materiali 064888-TR-AT do të
20 marrë numrin e provës P02090.5.

21 Materiali me numër 064888-TR-ET Pjesa 2 dhe shqipja do të
22 marrë numrin e provës P02090.6.

23 Dhe materiali 064888-TR-ET Pjesa 3 dhe përkthimi në
24 gjuhën shqipe do të marrin numrin e provës P02090.7.

25 Dhe Shënimi Përgatitor me numër 126641 deri në 126629 do

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 34

1 të marrë numrin e provës P02091.

2 Këto janë të gjithë numrat dhe ju lutem të më thoni
3 klasifikimin përkatës për secilin nga materialet.

4 Z. PACE: [Përkthim] Të gjitha materialet mund të jenë
5 publike, me përjashtim -- jo më falni, të gjitha materialet
6 mund të kenë klasifikimin publik.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
8 le të riklasifikohen të gjitha materialet si materiale
9 publike.

10 Z. Pace, a keni pyetje?

11 Z. PACE: [Përkthim] Po. Po përpara kësaj do të doja të
12 lexoja një përmbledhje të deklaratës së dëshmitarit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

14 Z. PACE: [Përkthim] Kjo është një përmbledhje e
15 deklaratës së dëshmitarit që është pranuar sipas rregullës
16 154.

17 Dëshmitari W04403 është shqiptar i Kosovës që ka pasur
18 role të ndryshme në UÇK në vendndodhje të ndryshme, përfshirë
19 dhe Dukagjinin. Dëshmitari 04403 ka qenë anëtar i Drejtorisë
20 Operative të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. 04403 do të
21 japë dëshmi lidhur me rolet që ka pasur ai dhe përgjegjësitë
22 që ka pasur pranë UÇK-së, takimet që ka marrë pjesë në '98-n
23 dhe '99-n, strukturën dhe organizmin e njësive të UÇK-së dhe
24 kontaktet që ka pasur ai me anëtarë të tjerë të UÇK-së.

25 PY. Dëshmitar, në intervistën që keni dhënë për ish-

1 Tribunalin e Hagës ju keni thënë që jeni takuar me Ibrahim
2 Kelmendin, Xhavit Halitin dhe në shtëpinë e Fehmi Lladrovci,
3 në Mynih. A ju kujtohet kur ka ndodhur ky takim?
4 PË. Po, ka qenë fund nëntori i vitit '97.
5 PY. A ju kujtohet kush ka qenë tjetër i pranishëm?
6 PË. Ka qenë Mark Shala, një gazetare nga Zagrebi, Diana
7 Rexhepi, ka qenë Ton Marku edhe Martin Berishaj. Po këta të
8 tjerët, përveç meje, nuk kanë qenë edhe në një takim tjetër që
9 e kemi pas vetëm une, Fehmi Lladrovci, Ibrahim Kelmendi edhe
10 Xhavit Haliti, të cilin atëherë e kam njoft veç si Zeka.
11 PY. Përmende Ibrahim Kelmendin. Në kohën e këtij takimi, në
12 dhjetor të '97-s, çfarë roli kishte Ibrahim Kelmendi?
13 PË. Nuk e di çfarë roli ka pas. Unë e kam njoft nga fëmënia
14 dhe i kam besu që është -- ka lidhjet e ngushta me UÇK që veç
15 vepronte në Kosovë prej vitit '92.
16 PY. Thatë, për korrigjim, thatë fundi i nëntorit të '97-s, jo
17 dhjetorit.
18 PË. Po mundet me ndodh, mundet me ndodh. Më falni. Ju e keni
19 kuptu që unë me data pak kam probleme.
20 PY. A mund të na thoni me sa keni ju dijeni, po Xhavit Haliti
21 çfarë roli kishte në kohë, në kohën kur është bërë ky takim?
22 PË. Nuk e ka prezantuar rolin e vet. Unë e kam njof veç, mu
23 ka prezantue veç si Zeka.
24 PY. Ndonëse ai nuk u prezantua mesa keni pasur ju dijeni, ai
25 çfarë roli kishte, edhe pse s'e tha ai vetë?

1 PË. Unë kam qenë i bindur që Xhavit Haliti, Fehmi Lladrovci
2 dhe Ibrahim Kelmendi paraqesin një -- paraqesin tre individë
3 të rëndësishëm në drejtimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
4 Fehmi Lladrovcin e njifsha nga studimet e mia në Zagreb kur
5 isha në akademi ushtarake. Ai pat ardh një vit pas meje dhe
6 studionte maqineri në Universitetin e Zagrebit. Po kisha besim
7 në këta të dy, në Fehmiun edhe në Ibrahimin.

8 PY. A ju kujtohet të jeni takuar me Ibrahim Kelmendin dhe
9 Xhavit Halitin pas këtij takimit që është mbajtur në shtëpinë
10 e Fehmi Lladrovcit?

11 PË. Me Ibrahim Kelmendin jam taku me -- por ma shpesh jam
12 taku pastaj me Fehmi Lladrovcin në Slloveni, në Lubjanë edhe
13 në Pragë të Çekisë dy herë, në '97-n edhe në fillim të vitit
14 '98.

15 PY. Të fokusohemi te takimi me Ibrahim -- takimet me Ibrahim
16 Kelmendin dhe/ose Xhavit Halitin pas këtij takimit të nëntorit
17 apo dhjetorit '97-s. Pra, a ju kujtohet ta keni takuar z.
18 Kelemendi dhe z. Xhaviti në një takim tjetër pas këtij takimi?

19 PË. Me Ibrahim Kelmendin është i pari që e kam taku kur kam
20 mbërri në Tiranë për t'u kyç në radhët e Ushtrisë Çlirimtare
21 të Kosovës me 8 mars 1998. Me Ibrahim Kelmendin dhe Xhavit
22 Halitin bashkë jam taku gjatë marsit të vitit ose fillim
23 prilli i vitit '98 në shtëpinë ku unë banoja atë kohë sa
24 qëndroja në Shqipëri. Por, gjithmonë për Xhavit Halitin e kam
25 dit që është Zeka.

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 37

1 PY. Në intervistën që e keni dhënë në 2005-n në TPNJ keni
2 përmendur librin.

3 Z. PACE: [Përkthim] Dua të nxjerr -- do kërkoj të dalë
4 një dokument në ekran me numrat përkatës U002-3041-U002-3143,
5 krahas me përkthimin në anglisht U002-3041-U002-3045-ET. Të
6 shohim faqen e parë në të dy versionet, ju lutem. Provat të
7 cilat do t'ju kërkoj të shfaqen sot në seancën të hapur mund
8 të transmetohen për publikun.

9 PY. Dëshmitar, në ekran majtas a e shihni në gjuhën shqipe
10 dhe në të djathtë përkthimin në anglishte po të njëjtit
11 material?

12 PË. Po.

13 PY. A është ky libri për të cilin e kishit fjalën në
14 intervistën që i keni dhënë TPNJ-së?

15 PË. Po. Jam pyet për librin dhe e kam pranë që është i imi.

16 PY. Titulli këtu përmend fjalët "Agim Zogaj" dhe në kllapa
17 "(Dialog me Naim Malokun)". Mesa keni ju dijeni a reflekton
18 libri me saktësi atë që është thënë në dialog?

19 PË. Po libri përfaqëson atë 'Çka une i kam thon Agim Zogaj në
20 intervistën që e ka bo me mu.

21 PY. Dhe mesa keni ju dijeni, informacioni që ju keni dhënë
22 gjatë asaj interviste a ka qenë i vërtetë?

23 PË. Mund të ndodhë që ka pas ndonjë ekzagjerim të vogël, por
24 në përgjithësi libri pasqyron të kalumen time dhe veprimtarinë
25 time për periudhat për të cilat jam pyt.

1 PY. A ju kujtohet ndonjë problem në veçanti apo ndonjë
2 incident për të cilin keni bërë ndonjë ekzagjerim në këtë
3 dialog?

4 PË. Është te një rast kur pyetem për si kemi arrit me e bind
5 Misionin Vëzhgues Ndërkombëtar në Kosovë që Ushtria Çlirimtare
6 e Kosovës ka strukturë e cila respektohet nga nivelet
7 organizative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. I kam përmend
8 dy raste, dy raste. Ju e dini që në vjeshtën e vitit '98 me
9 Rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
10 emërohet Misioni Vëzhgues Ndërkombëtar në Kosovë i cili ka
11 vëzhgu, monitoru jo vetëm ngjarjet në përgjithësi ç'ka bojnë
12 forcat serbe, por edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe
13 veprimtarinë tonë. Sa dinë unë, shumë herë janë taku edhe me
14 mu edhe njerëz të tjerë për tanë kohën sa kanë qenë në Kosovë.

15 Kam përmend dy raste në të cilat ne kemi dëshmu që jemi
16 ushtri serioze, për ata edhe kemi marrë pjesë në Konferencën
17 Paqësore në Rambuje, e cila gjithashtu është mbajt me Rezolutë
18 të Këshillit të Sigurimit. Janë një rast i rrëmbimit -- i
19 zënien rob të tetë ushtarëve në Zonën Operative të Shalës, e
20 që bisedimet për lirin e tyre janë bo nga Shtabi i
21 Përgjithshëm, nga përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm në
22 Likoc edhe në Dragobil, edhe për një operacion për të cilin
23 kam qenë rastësisht unë në Drejtori Operative dhe është
24 zhvillu në Mitrovicë, ku përmes përfaqësuesve, vëzhguesve
25 ndërkombëtarë Serbia kërkonte që një njësit i joni në

1 Mitrovicë të dorëzohet.

2 Ata që ndërmjetësonin nga faktori ndërkombëtar garantonin
3 kinse fjalët e palës kundërshtare që do t'i përmbahen ligjeve
4 dhe trajtimi i atyne ushtarëve do të jetë sipas ligjeve
5 ndërkombëtare. Ne normalisht ka qenë vullneti edhe i atyne
6 ushtarëve, dëshira që mos me u dorëzu.

7 Ne e kemi e zhvillu një operacion, për shkak se kemi pas
8 pajisje në Drejtori Operative me i përgjigj forcat e armikut,
9 forcat serbe që ishin në rrethim, që e kishin rrethu njësinë
10 tonë atje, dhe e dinim korridorin kah muj me ju shku në ndihmë
11 edhe me i nxjerrë. Aty na u ka vra një ushtar, është plagos
12 një, mirëpo e kemi tërhyek njësinë dhe pala kundërshtare është
13 nda bukur keq aty.

14 PY. Në lidhje me këto incidente, ju lutem, sqarojini
15 Gjykatësve se çfarë mund të keni ekzagjeruar në libër, nëse
16 keni ekzagjeruar diçka.

17 PË. Po unë e kam ekzagjer -- po ndoshta e kam paraqit
18 strukturën organizative dhe zinxhirin komandues si strikt. Unë
19 dua t'ju sqaroj që Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë ushtri
20 e rregullt vullnetare, pra prej ushtarit të parë e deri në të
21 fundit ka qenë vullnetare, pra krejt pjesëtarët. Nuk ka qenë e
22 mobilizume në bazë të ligjeve të qeverisë, Ministrisë së
23 Mbrojtjes e të tjera, por është vetëorganizu në baza
24 vullnetare.

25 Z. Prokuror, është rregull edhe në ushtri të tjera, çdo

1 ushtri ose njësi vullnetare ka do përgjegjësi, obligime që
2 dallojnë nga ushtritë dhe njësitë të cilat mobilizohen në bazë
3 të ligjeve edhe urdhrave. Për shembull, në qoftë se një ushtar
4 që vjen vullnetar paraqitet në brigadë dhe vjen vullnetar, pas
5 një muaji për shkak të shkaqeve të ndryshme ai e lëshon
6 njësinë, nuk quhet dezertim, se ai vullnetarisht ka ardh dhe
7 vullnetarisht shkon. Edhe te zbatimi i urdhrave, zinxhiri
8 komandues mundet njësia, njësi apo ushtari vullnetar mos me
9 e zbatu ndonjë urdhën edhe ai nuk përgjigjet para, do të
10 thotë, organeve që ajo ushtri vullnetare i krijon për të kriju
11 dhe ndërtu disiplinë brenda strukturës së asaj ushtrie.

12 Pra, këto janë dallimet që e dallojnë një ushtri e cila
13 ndërtohet me ligje, në bazë të ligjeve dhe nga institucionet e
14 shtetet me ushtritë e rregullta vullnetare që organizohen
15 vetorganizohet, dhe krejt pjesëtarët prej të parit e deri të
16 fundit janë vullnetarë. Ky ka qenë një ekzagjerim shumë i
17 vogël, jo i madh, do të thotë. Por ne jemi respektu, njësitet
18 tona e kanë respektu Shtabin e Përgjithshëm, është respektu
19 struktura, komandanti i brigadës i zonës, por ne instalimin e
20 zinxhirit komandues duhet me pas parasysh që te njësitë
21 vullnetare nuk shkon njëjtë sikur te njësitë të cilat, ose te
22 ushtarët të cilët mobilizohen urdhra dhe në bazë të ligjeve,
23 dhe në qoftë se i thejnë ato ligje përgjigjen përpara organeve
24 të drejtësisë të atij shteti.

25 Z. PACE: [Përkthim] T'i kthehem faqes që mbaron me

1 numrin 2043 në të dy versionet.

2 PY. Dëshmitar, këtu shohim të përmendet viti 2000. Ky ka qenë
3 viti kur është botuar ky libër që përmban intervistën tuaj?

4 PË. Po a libri që është botu dhe kjo historia ime e paraqitur
5 në këtë libër jam unë.

6 PY. Është botuar në vitin 2000?

7 PY. Po, në 5000 kopje.

8 Z. PACE: [Përkthim] Në gjuhën shqipe kalojmë në faqen që
9 mbaron me shifrën 3088, që është faqja 30 -- 48, më falni.

10 Ndërsa në anglisht do nxjerrim një përkthim tjetër që
11 është U002-3080-U002-3141-ET. Është në PDF faqja numër 9.

12 PY. Do të lexoj nga fillimi i paragrafit të dytë, Dëshmitar.
13 Mund ta ndiqni ose në shqip ose të dëgjoni përkthimin në shqip
14 dhe pastaj të bëjmë pyetje.

15 "Gjatë qëndrimit në Tiranë, kisha një -- më ndodhi diçka
16 me dy individë të cilët u prezantuan në emër të Shtabit të
17 Përgjithshëm të UÇK-së, i cili erdhi dhe më tha që nuk kishin
18 nevojë për oficerë. Këta njerëz u prezantuan si Besniku nga
19 rrethi i Pejës, dhe Dervishi nga Drenica."

20 Z. PACE: [Përkthim] Në fakt në shqip është në anën e
21 majtë.

22 DËSHMITARI: Po, më kujtohet ai takim.

23 Z. PACE: [Përkthim]

24 PY. "Më thanë se UÇK-ja ende nuk i ka strukturat për të
25 inkorporuar oficerët me shku në luftë, që për mu s'kishte

1 kuptim. Asokohe isha ende në kontakt me Ilir Konushevcin, i
2 cili nguli këmbë që oficerët të shkonin në Kosovë. Mesa di
3 unë, edhe Shtabi i Qendror i UÇK-së, një pjesë e udhëheqjes
4 ishte në favor që oficerët të hynin në Kosovë, ndërsa një
5 pjesë tjetër ishte kundra. Dhe sipas mendimit tim të dyja
6 palët kishin të drejtë. Një herë, për shembull, Xhavit
7 Halimit, më tha se djemtë e UÇK-së kishin rezerva kundër
8 oficerëve sepse kishin shërbyer në një ushtri tjetër.”

9 Tani pyetja e parë që kam është kjo: Kur, takimi me dy
10 individët që ju përmendni këtu, ka ndodhur? Pra, në ç’muaj dhe
11 në ç’vit?

12 PË. Ka qenë fundi i marsit '98.

13 PY. Që është në vitin 1998?

14 PË. Po. Po këtu e kam zbut, z. Prokuror. Këto që të dyja
15 palët kishin të drejtë. Kjo pala që kishte rezerva ndaj nesh,
16 nuk kishte të drejtë fare. Ne jemi prit oficerët shqiptarë me
17 duar hapur në luftra në Slloveni, në Kroaci, në Bosnje dhe
18 kemi lon emra, po emra të pashlym në ato luftëra, dhe rezervat
19 që shpreheshin ndaj nesh kanë qenë të padrejta, ka qenë
20 kontraproduktive dhe dëmtuese për luftën dhe për fillimin do
21 të thotë ngritjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

22 Ushtria Çlirimtare e Kosovës sipas nesh ka pas nevojë
23 kyçjen sa më të shpejtë të kuadrit profesionist të shkolluar,
24 menjëherë në Kosovë për ngritjen e strukture organizative edhe
25 për ngritjen e rezistencës ma efikase, ma profesionale për

1 Çlirimin e Kosovës. E kam zbut pak për shkak të një balance që
2 unë e kam mbaj tan jetën edhe krejt luftë, do të thotë.

3 Edhe viti 2000 ishte karakteristik në Kosovë. Kishte
4 përfundu lufta dhe unë mundohesha të mbaj balancën, do të
5 thotë, mes edhe vijave të ndryshme qoftë politike, qoftë po --
6 dhe kjo është ajo që une deshta të plotësoj këtu.

7 PY. Emrat e dy individëve, ata që u prezantuan si në emër të
8 Shtabit Qendror të UÇK-së a u a morët vesh?

9 PË. Po, e kam marrë vesh pas lufte. Besniku është Hysen
10 Kazheli ishte. Kishte qenë shumë afër me shtëpi afër shtëpisë
11 time, po unë kam dal i ri nga Kosova edhe nuk e njifsha.
12 Ndërsa për Burimin kishte qenë i një fshati, më duket Dush,
13 Marmullak, unë s'e kam dit, po në atë familje të tij unë e kam
14 të martuar një vajzë të axhës, një kushëri të largët të tij.

15 PY. Ju kujtohet mbiemri i Burimit?

16 PË. Marmullaku është.

17 PY. Në këtë pjesë përmendët Ilir Konushevcin. E dini çfarë
18 roli luante ai në atë kohë për të cilën flisni këtu në mars
19 '98-s?

20 PË. Ilir Konushevcin ishte njeri kyç i logjistikës për
21 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në Shqipëri, edhe ai ishte
22 këmbëngulës, do të thotë se që sa ma shumë oficerë, sa ma
23 shumë ushtarakë të futen në Kosovë në radhët e Ushtrisë
24 Çlirimtare të Kosovës. E di që ka bë përpjekje maksimale që sa
25 ma shumë, do të thotë, kolegë të mitë që ishin me përvoja në

1 luftuar në Kroaci dhe Bosnje me ardh në Kosovë, dhe shumë prej
2 tyne i kam thirr edhe me kërkesën e tij, sugjerimet e tij edhe
3 të Ibrahim Kelmendit, mos të harrojmë. Edhe ai ka qenë me një
4 vijë që sa ma shumë njerëz të kyçemi dhe kanë ardh.

5 Më kujtohet që unë i kam prit edhe Kadri Kastratin, edhe
6 Din Agashin, edhe Xhelal Hajdën, Tonin, edhe Idriz Balën, dhe
7 përmes linjës së Ilir Konushevcit edhe Qerim Kelmendit që
8 ishte në Bajram Curr, i kemi fut në Kosovë.

9 PY. Sa -- nga i dinit ju për atë çka, pra, këtë që keni thënë
10 ju këtu, pra, që një pjesë e Shtabit Qendror të UÇK-së ishte
11 pro hyrjes së oficerëve në Kosovë e një pjesë tjetër ishte
12 kundër hyrjes së tyre në Kosovë? Nga e dinit?

13 PË. Si nisi lufta në Kosovë, na oficerët, një numër i madh i
14 tyne kemi ardh nga të gjitha vendet. Unë jam ardh nga
15 Sllovenia. Beteja e Prekazit ka nis me 5 mars, unë jam ardh me
16 8 mars në Kosovë -- në Tiranë, me uniformën time që e kam pas
17 nga luftimet në Kroaci. Atë uniformë unë e pata rujt te do
18 shokë të mitë.

19 Pastaj kanë ardh, Bislim Zyrapi, Agim Ramadani, Hafir
20 Hoxha, Xhafer Gashi, Kadri Kastrati, kanë ardh prej -- ka ardh
21 ky Agim Çela. Kanë ardh prej Kroacisë Xhafer Kabashi, edhe të
22 tjerë që ndoshta tash s'më kujtohen. Dhe prej të gjithë neve
23 oficerëve u caktu Bislim Zyrapi me pas lidhje me një shtab, ne
24 e merrshim që një shtab qendror i Ushtrisë Çlirimtare të
25 Kosovës që është në Tiranë. Bislimi ishte ajo lidhja e gjithë

1 oficerëve që rrishim bashkë në Tiranë, që ishin ardh prej të
2 gjitha anëve për t'u kyç në Kosovë me q'atë shta, që unë kurrë
3 s'jam interesu as ku e ka selinë as shtëpinë, as sot nuk e di.
4 Dhe ajo thonte që ka rezerva për futjen tonë në Kosovë edhe në
5 ngritjen e strukturave organizative të UÇK-së brenda.

6 PY. Sapo përmendët se keni shku në Tiranë më 8 mars. Dhe në
7 intervistën me ZPS-në, Prokurorinë këtu, thatë që e keni kalu,
8 keni hy - më falni - në Kosovë më 21 prill. Mund të sqaroni
9 ju, pra e kishit pas ndërmend vërtetë kështu që të qëndronit
10 në Shqipëri rreth një muaj e gjysëm?

11 PË. Jo, unë kam qenë i bindur që brenda një dite, dy do të
12 hymë në Kosovë.

13 PY. Po pse nuk keni hy në Kosovë brenda një, dy ditësh?

14 PË. Po ashtu ishte -- ishin geto kinse si përgatitje. Unë
15 pastaj nuk ndejta ashtu kot. Jemi kyç me Bislim Zyrapin ndihmë
16 Ilir Konushevcit edhe strukturës, ngritjes së strukturave të
17 kampeve në Shqipëri. Me Bislim Zyrapin e kemi ngrit një kamp
18 të trajnimit të ushtarëve në Qerret, afër Durrësit.

19 I kam caktu Bislimin, Din Agashin edhe Kadri Kastratin me
20 u marr me trajtimin e vullnetarëve që vishin, vishin
21 vullnetarë nga të gjitha anët për me u kyç. Dhe ne ishim të
22 mendimin që duhet me pas ata një përgatitje, së paku
23 fillestare ushtarake, para se të hyjnë në Kosovë. Ky Agim
24 Ramadani, Hafir Hoxha edhe Xhafer Gashit e ngritën një kamp në
25 një mal Dajti, që quhet, afër Tiranës. Po u ngritën dy kampe

1 për trajtimin e ushtarëve.

2 Unë, Bislizm Zyrapi edhe Naser Idrizi shkuam në bazat e
3 logjistikës në Kukës edhe në Bajram Curr për të ngrit
4 strukturën organizative të bazave që armët të cilat
5 grumbulloheshin në ato baza me u dekonservu, me u ba
6 kontrollimi teknik i tyre dhe që ushtarët kur të marrin armën
7 me shku në Kosovë, arma me qenë funksionale, se kjo nuk kishte
8 pas ndodh. Kjo nuk kishte qenë ky organizim në ato baza. Ju
9 jepshin ushtarëve armët e konservume dhe kishim dëgjju që kish
10 pas raste që kanë qenë armët jofunksionale kur kanë ra
11 ushtarët në pritë. Pra, këto i kemi ba.

12 Tjetër, pjesët e tjerave armëve ju kemi -- i kemi
13 këshillu dhe mësu se si duhet, për shembull, minat anti-tanke
14 kanë qenë tri lloje, secila e ka pas shkrepësen e vet
15 mekanike. Pra duhet mina adekuate me pas shkrepësen e vet
16 adekuate, jo me ju dhanë të ndryshme se e bart kot në
17 Shqipëri. Pra, më kujtohet që këto i kam spjegu unë në Bajram
18 Curr se unë i kam njoft, e kam njoft këtë armë, se gjatë
19 shkollimit kam qenë i shkolluar për këtë lloj arme dhe më
20 kujtohet mirë që e kemi bërë një punë të mirë që ushtarët që
21 vijnë vullnetarë nga perëndimi, ma së pari me kalue në kampet
22 e trajnimit, pastaj me shku në bazat e logjistikës me i marrë
23 armët funksionale dhe me to me hy në Kosovë. Pra, me qenë
24 armët teknikisht në rregull. Mendoj që kjo është një punë e
25 mirë e neve profesionistëve që e kemi bo.

1 Dhe duhet Gjykatën dhe ju, z. Prokuror, t'ju njoftoj për
2 një fakt, që në fillim të prillit të vitit '98, Bislim Zyrapi,
3 Agim Ramadani dhe unë kemi vendos që në Ushtrinë Çlirimtare të
4 Kosovës mos me pas mina kundër këmbësorisë. Pra, ju lutem,
5 është e vetmja ushtri që gjatë tanë kohës sa ka vepru dhe
6 funksionu nuk ka qenë e trajnume as nuk ka pas në përdorim
7 armë, do të thotë, minat e anti-këmbësorisë. Toka jonë ka
8 qenë, shteti jonë ka qenë, ato mina kanë mujt me met aty të
9 fshehura dhe dekada ma vonë me dëmtu fëmijë, civilë, kafshë,
10 pra. Dhe këto ja kemi komunikue Ilir Konushevcit dhe i kemi
11 thanë. Jo, urdhër, na nuk kemi pas mundësi me i dhanë urdhër,
12 Ilir Konushevcit, por e kemi këshillu dhe i kemi thënë që
13 "Kurrë mos t'ju jep ushtarëve dhe të mos mësohen ushtarët për
14 përdorimin dhe minimin dhe krijimin e fushave të minave anti-
15 këmbë -- kundër-këmbësorisë në territorin e Kosovë. Kurdo që
16 të ndodhë në histori në të ardhmen ndonjë incident i tillë,
17 Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka me qenë e liruar nga fajësia
18 që është fajtore që një fëmijë apo një diçka, një civil
19 dëmtohet nga minat kundër këmbësorisë.

20 E di, e kemi dit që as Rusia, as Amerika nuk i ka
21 nënshkru ato konventa për mospranimin e armëve, e minave anti-
22 këmbësorisë, po ne e kemi zbatu. E kemi nënshkru pa e
23 nënshkru.

24 PY. Dëshmitar --

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace. Do

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 48

1 bëjmë pushimin e drekës.

2 Z. PACE: [Përkthim] Vetëm një pyetje para se të bëjmë
3 pushimin.

4 PY. Dëshmitar, ju u përgjigjët. Ju lutem, për pyetjet e tjera
5 të jeni pak më i shkurtër dhe nëse ju ngre unë dorën do të
6 thotë që po dilni përtej kuadrit të pyetjeve të mia. Që të
7 jemi sa më efikasë me kohën. Në rregull?

8 PË. Faleminderit, faleminderit.

9 PY. Faleminderit. Do bëjmë pushimin tani.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
11 pushimin e drekës tani, Dëshmitar. Na falni që pritët kaq
12 shumë sot paradite, po kishim një aspekt të domosdoshëm për ta
13 trajtuar. Do bëjmë --

14 DËSHMITARI: Jo, unë jam në dispozicion të drejtësisë.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
16 pushim deri në orën 2.30. Largohuni tani nga salla.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
19 deri në orën 2.30.

20 --- Pushimi i drekës fillon në orën 13.02

21 --- Seanca rifillon në orën 14.30

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
23 vijë dëshmitari, do të japim vendim lidhur me kërkesën e
24 Mbrojtjes së Veselit, për zgjatje afati.

25 Më 19 mars 2025, Mbrojtja e Veselit kërkoi përmes postës

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 49

1 elektronike që t'i shtohet, t'i zgjatej afati Mbrojtjes për
2 t'iu përgjigjur parashtimit të Prokurorisë me numër F03028
3 dhe kërkuan që të shtyhej afati deri në 9 prill 2025.

4 Prokuroria u shpreh se nuk e kundërshton kërkesën.

5 Pasi morëm parasysh kërkesën dhe duke marrë parasysh edhe
6 kalendarin për mbylljen e provave të ZPS-së më 4, më 15 prill
7 2025, Trupi Gjykues në bazë të rregullës 9(5) e zgjat afatin
8 për t'iu përgjigjur parashtimit të protokolluar F03028, deri
9 në datën 4 prill 2025. Kundërpërgjigjet do të dorëzohen brenda
10 afateve të përcaktuara në rregullën 76.

11 Me kaq mbyll urdhrin me gojë.

12 Ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë tani.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Mirë. Z. Maloku, do të
15 vazhdojmë me pyetjet e Prokurorit. Vetëm ju lutem dëgjojeni
16 pyetjen dhe përgjigjuni vetëm pyetjes në mënyrë koncize. Mos
17 flisni për aspekte që nuk janë objekt i pyetjes, ju lutem.

18 Z. Pace, fjala është për ju.

19 DËSHMITARI: Faleminderit.

20 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Do i lutem Sekretarisë
21 të heqë nga ekrani dokumentin.

22 PY. Mirëdita, Dëshmitar.

23 PË. Mirëdita.

24 PY. Në intervistën për ish-Tribunalin e Hagës, ke përmendur
25 një takim në Dobrosh, ku ka qenë dhe shtabi i -- Recaj --

1 PËRKTHYESI: Shqiptimi sipas Prokurorit.

2 Z. PACE: [Përkthim]

3 PY. A ju kujtohet kush ka marrë pjesë në takimin në Dobrosh?

4 PË. Ka qenë gjysma e dytë e qershorit. Edhe në Dobrosh janë
5 takue komandantët e shtabeve të 20 fshatrave, pra pasi është
6 marrë Juniku. Juniku ka qenë fshati ma i madh në Kosovë në atë
7 kohë. Ne Junikun e kemi marrë me luftë, me operacion,
8 operacion të mirëfilltë të organizum, pasi pat ardh Sali
9 Veseli. Sali Veseli pat ardh në fund të majit aty dhe jemi
10 takue në fshatin Dobrosh diku kah gjysma e dytë e qershorit të
11 vitit 1998.

12 PY. Sali Veseli vetë ka qenë te ky takimi i Dobroshit?

13 PË. Po, po. Ishte organizimi i Sali Veselit. Ai ishte oficeri
14 me gradën ma të lartë që kishte hy deri atëherë në Kosovë.
15 Pra, ne kemi hy sipas gradave, sipas pozicioneve që i kemi
16 pas, ose përgatitjeve shkollore. Sali Veseli ishte me akademi
17 të shtatmadhorisë, ushtarak, dhe ishte me gradën major. Pra,
18 ai ka ardh aty dhe jemi takue për të zhvillu brigadën e Rekës
19 së Keqe.

20 PY. Sali Veseli a kishte ndonjë pseudonim a nofkë në kohën
21 kur është mbajtur ky takim?

22 PË. Po, ishte Vetëtima ai.

23 Z. PACE: [Përkthim] Ma, ju -- mund të na e thotë dhe një
24 herë përkthyesi çfarë emri përdori dëshmitari, cila qe nofka?
25 Cila qe nofka nga përkthyesi?

1 DËSHMITARI: Unë, e kam pas një kohë -- po unë --

2 Z. PACE: [Përkthim]

3 PY. Një çast, Dëshmitar. Ju lutem, Dëshmitar, thojeni dhe
4 ngadalë dhe një herë ngadalë ju lutem nofkën në shqip,
5 germëzoheni nofkën në shqip të Sali Veselit.

6 PË. Vetëtima. Vetëtima.

7 PY. Faleminderit. A mund t'i thoni shkurtimisht Gjykatësve
8 çfarë u diskutua në takimin e Dobroshit ku ka qenë edhe Sali
9 Veseli?

10 PË. U diskutue për atë që ishin 20 fshatra nën kontrollin e
11 UÇK-së, në atë territor. Pra, Juniku dhe 19 fshatra të tjera.
12 Secili fshat e kishte shtabin e vet të UÇK-së. Gjatë kohës sa
13 unë qëndrova në atë territor, kishim, i kishim dy kampe
14 trajnimi. Një unë e udhëheqsha, edhe një Afrim Basha me
15 pseudonimin Abi. Ishin kriju pra njësite --

16 PY. Një çast, ju lutem. Po dilni pak nga pyetja. Jam i
17 interesuar shkurtimisht në atë takim çfarë u diskutu?

18 PË. U diskutua që kemi territor të mjaftueshëm nën kontroll
19 për të zhvillu brigadën.

20 PY. Faleminderit.

21 Z. PACE: [Përkthim] Tani do kërkoja të dilte në ekran
22 materiali IT-04-84, përndryshe prova materiale P00130 përbri
23 me anglishten, që ka të njëjtin numër. Thjesht ka prapashitesën
24 ET. Ju lutem, të shohim faqen e parë të të dyja varianteve.

25 PY. Dëshmitar, në të majtë e keni në shqip dokumentin, në të

1 djathtë është anglishtja. Dokumenti në shqip, a e keni parë
2 përpara se t'ua tregoja unë javën e kaluar?

3 PË. Unë përpara nuk e kam pa, por përmbajtja e këtij
4 dokumenti është e saktë.

5 PY. Do flasim për atë. Shohim që titulli thotë: "Mbledhja
6 themeluese e shtabit të Rekës për Ushtrinë Çlirimtare të
7 Kosovës." Edhe data këtu është 15 qershor 1998, Dobrosh. E
8 shihni?

9 PË. Po, po.

10 PY. Shohim fjalinë e parë që thotë:

11 "I pranishëm, Vetëtima. Major i emëruar komandant ..."

12 Vazhdojmë më poshtë, në fund të faqes, edhe shohim që
13 edhe nënshkrimi është i komandant Vetëtimës. A mund të na
14 thoni kush është ky komandant Vetëtima?

15 PË. Ky është Sali Veseli.

16 PY. Sipas jush, a është ky nënshkrimi i Sali Veselit, i
17 Vetëtimës?

18 PË. Po, ky është nënshkrimi i Sali Veselit. Të gjithë
19 dokumentet që i ka lëshu pastaj për emërimet në komandë, në
20 shtab të komandës së brigadës, dhe komandantët e batalioneve
21 janë, më kujtohet që është nënshkrimi i tij ka qenë.

22 PY. Përbri nënshkrimit në të majtë shohim që përmendet një
23 emër, Lum Haxhiu, procesverbal-mbajtës. A e dini kush është
24 Lum Haxhiu?

25 PË. Ky ishte Hajdin Abazi që erdhi nga Suedia. Ishte një

1 intelektual, e dinte gjuhën angleze, edhe u emëru në shtabin e
2 brigadës për komunikimin me media edhe me përfaqësues të
3 faktorit ndërkombëtar kur vinin për me na vizitu.

4 PY. Tek rreshti i dytë, shkojmë më lart në të dyja versionet.
5 Shohim që përmendet Agroni, Kapiten. A e dini kush është?
6 Agroni, Kapiten. Kush është ky?

7 PË. Agroni ka qenë Rifat Sylejmani, me akademi të kryme
8 ushtarake. Erdh bashkë me Sali Veselin dhe u emëru komandant i
9 Batalionit të 2-të.

10 PY. Në rreshtin e tretë përmendet Besniku. A ka qenë
11 pseudonimi juaj ky në kohën e këtij takimi?

12 PË. Unë kam hyrë në Morinë më 21 prill 1998, si Naim Maloku.
13 Por kur mbas dy dite kam dëgju lajmin që propaganda serbe ka
14 shpall që jam vra, e kam marrë Besniku për një kohë. Pra, edhe
15 kam ndërru vend, kam dalë në Suhalicë. Ky është një pseudonim
16 që unë e kam mbajtur diku një muaj, një muaj e gjysmë, deri
17 kah fundi i qershorit, fillim të korrikut.

18 Z. PACE: [Përkthim] Shohim fagen e dytë në të dyja
19 versionet.

20 PY. Dëshmitar, e njëjta pyetje. Këtë dokument, e keni parë
21 ndonjëherë përpara se sa t'jua tregoja unë javën e kaluar,
22 shqipen?

23 PË. Dëgjo, unë sigurisht shumë dokumente i kam pa, por në
24 kujtesën time s'ka qenë që e kam pa. Ky është dokument i cili
25 është lëshu nga komandanti i brigadës Sali Veseli.

1 Z. PACE: [Përkthim] Shkojmë më poshtë, në fund të faqes.

2 Shohim nënshkrimin këtu.

3 PY. Dëshmitar, e njihni këtë nënshkrim?

4 PË. Po, është i Sali Veselit.

5 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë

6 pranimin e këtij dokumenti.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

8 kundërshtime?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

12 atëherë. Materiali që mban numrin IT-04-84 P00130 bashkë me

13 anglishten pranohet. Ju lutem, t'i jepni numrin përkatës.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë

15 numrin e provës 02092 edhe vërej që ka klasifikim publik në

16 *Legal Workflow*.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të mbetet

18 publik si dokument.

19 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin nga ekrani

20 tani. Tani do të doja të vendosen në ekran 126674-126682.

21 Përbri me përkthimin, që ka numrin 126674-126679-ET, dhe të

22 shohim faqen 126678 në të dyja versionet. Faleminderit.

23 PY. Dokument [Sipas përkthimit], e shihni dokumentin në të

24 majtë të ekranit tuaj? Dokumentin me ngjyra?

25 PË. Po.

1 Z. PACE: [Përkthim] Shohim faqen tjetër. Kjo është faqja
2 12679 [Sipas përkthimit].

3 PY. E njihni, e shihni këtë faqe në ekran?

4 PË. Po.

5 Z. PACE: [Përkthim] Kthehemi në faqen pararendëse, ju
6 lutem. Në faqen 126678. Jua thashë dhe më herët sa herë të
7 jemi në seanca publike këto mund t'i përcillen dhe publikut.

8 PY. Dëshmitar, a ia keni dhënë ju këtë dokument ZPS-së?

9 PË. Po.

10 PY. Kur e ke marrë këtë dokument?

11 PË. E kam marrë dikur në dhjetor të vitit 1998, kur na u kanë
12 lëshu kartat e identifikimit të gjithë personelit që ishim në
13 Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe
14 këtë e kam mbajtur deri në fund të luftës.

15 PY. Ku ke qenë, në cilin vend ke qenë kur ta kanë dhënë këtë
16 dokument?

17 PË. Kemi qenë në selinë e Shtabit të Përgjithshëm, në fshatin
18 Divjakë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë
20 pranimin e këtij dokumenti. Ua thashë edhe një herë, dokumenti
21 ka numrin 126674-126628, faqet 126678, dhe 79 në fund.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
23 kundërshtime?

24 Z. DIXON: [Përkthim] S'kemi kundërshtime.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, s'ka

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 56

1 kundërshtime.

2 Materiali 126674, 126628 [Sipas përkthimit] Dhe përkthimi
3 në faqen 126678 dhe 79 pranohen.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto faqe do të marrin
5 numrin e provës P02093. Ju lutem, a mund të më konfirmoni
6 klasifikimin nëse është publik?

7 Z. PACE: [Përkthim] Po, mund të jetë dokument publik. Dhe
8 ndërkohë mund ta heqim dokumentin nga ekrani.

9 PY. Dëshmitar, në intervistën për ZPS-në dhe gjatë seancës
10 përgatitore ju thatë që jeni bërë anëtar i Shtabit të
11 Përgjithshëm të UÇK-së edhe keni shkuar për herë të parë në
12 Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së më 15 nëntor të 1998 dhe atë
13 ditë keni parë Sali Veselin atje. Po ashtu keni thënë se
14 Bislim Zyrapi të ka ftuar të bëheshe pjesë e Shtabit të
15 Përgjithshëm të UÇK-së.

16 Tani unë kam këtë pyetje, kur të ka ftuar Bislim Zyrapi
17 të kyçeshe në UÇK, në Shtabin e Përgjithshëm.

18 PË. Bislim Zyrapi e ka dit që jam në Lladrovc. Isha i strehum
19 te dajat e mi, për shkak që kam qenë i plagosur. Dy ditë
20 përpara kam takue unë Bislim Zyrapi, para 15 nëntorit. Dhe më
21 15 nëntor Bislim Zyrapi e ka dërgu makinën për mu në fshatin
22 Lladrovc, te dajat e mi. Ka qenë Jeep Cherokee. E kemi
23 konsideru që është xhipi i shefit të shtabit. Edhe shoferin,
24 edhe më ka marrë mu, edhe kam shku unë në Shtab të
25 Përgjithshëm.

1 PY. Ditën tënde të parë atje, pra më 15 nëntor të 1998,
2 përveç Sali Veselit, a takove, a pe ndonjë person tjetër atje?
3 PË. E kam pa aty Shaban Dragën, e kam pa që ka qenë shefi i
4 Brigadës 121, por e ka pas selinë afër shtabit. Edhe, Sali
5 Veselin e kam pa. Më kujtohet, se ma prezantoi Bislimi, tha --
6 jo ma prezantoi, por më tha që "ky do të është, drejtorinë
7 operative, shefi yt". Do të thotë, për Sali Veselin. Për Sali
8 Veselin, unë pra e njifsha prej Junikut. Edhe s'më kujtohet më
9 të tjerë, ndoshta kam pa edhe të tjerë unë, nuk më kujtohet.
10 PY. Në intervistën që i keni dhënë Speciales së Kosovës të
11 2016, ju keni thënë që Shtabi i UÇK-së ishte në Divjakë, pranë
12 Kleçkës. A mund të na e përshkruani pak ndërtesën apo
13 ndërtesat --
14 PË. Po.
15 PY. -- që përdorte Shtabi i Përgjithshëm kur keni qenë ju
16 atje në nëntor, nga nëntori i 1998?
17 PË. Po fillimisht ka qenë një shtëpi që dallohej prej
18 shtëpive të tjera të fshatit, që e kishte fasadën e bardhë.
19 Pra, e ngjyrosur nga jashtë me ngjyrë të bardhë. Dhe të gjithë
20 ne i thonim shtëpia e bardhë. Mbasi Amerika e ka Shtëpinë e
21 Bardhë edhe ne e kishim, a më kupton. E qashtu një farë forme.
22 Pastaj kanë qenë edhe dy-tri objekte përcjellëse të asaj
23 fermës, asaj shtëpie fshatare, që pastaj u rinovu dhe u bënë
24 për nevoja të drejtorive operative për nevojën e shefit të
25 shtabit, edhe për nevojat e më duket, ushtarëve që e rujshin,

1 që e rujshin Shtabin e Përgjithshëm.

2 Pra, ishin ndërtesa që ai fshatari i kishte pas për
3 bagëti, për nevoja të tjera të fermës, aty ato pastaj u
4 rinovun, u përmirësun, dhe u ngritën, u zhvillun pra
5 drejtoritë, drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm. Fillimisht
6 kam qenë i vendosur në shtëpinë e bardhë.

7 PY. Në intervistën për ZPS-në keni thënë që shefi i
8 drejtorisë operative ka qenë gjeneral Ramiz Beqi --
9 PË. Beqi.

10 PY. -- Beqi. Por ai nuk erdhi asnjëherë në Kosovë, dhe
11 zëvendësi i tij -- ju kërkojmë ndjesë për shqiptimin. Dhe
12 zëvendësi i tij ka qenë Sali Veseli. Gjatë seancës përgatitore
13 e sqaruat --

14 PË. Po.

15 PY. -- dhe thatë që në fakt keni qenë ju komandanti i dytë,
16 apo zëvendësi i dytë, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Ju lutem, na e sqaroni kush ua ka dhënë detyrat, kush t'i
19 caktonte detyrat kur ishe anëtar i drejtorisë operative?

20 PË. M'i ka caktue, detyrën e parë e kam marrë më 18 nëntor që
21 ka zgjat deri më 27 nëntor, e kam marrë prej Bislim Zyrapit.
22 Me shku në territorin e Brigadës 122, në fakt nuk kishte më
23 brigadë, nuk ishte brigadë, por ishin njësitet Lumi. Dhe me
24 komandantin e brigadës që u emëru për atë brigadë, por duhej
25 zhvillu brigadën atje. Njësitet Lumi me i sistemu në brigadë.

1 Pra, kam shku prej 18 deri më 27, i bien nëntë ditë. E
2 kam shoqëru komandantin e brigadës i emërum për të qenë
3 komandant brigade, Vesel Maliqin, edhe komandantin e
4 Batalionit 1, Agim Lekën, nëpër të gjitha fshatrat dhe
5 njësitet Lumi që me i prezentue komandantin e ri të brigadës,
6 edhe me u takue me njësitë edhe me popullatën civile. Kjo
7 është detyra që ma ka dhanë detyrën e parë ma ka dhanë shefi i
8 shtabit Bislim Zyrapit.

9 PY. Gjatë kohës që keni [Sipas përkthimit] anëtar i
10 drejtorisë operative, përveç Bislim Zyrapit, a të ka caktuar
11 detyra ndonjë person tjetër? Më intereson kush, jo detyrat në
12 vetvete, por në qoftë se ka pas ndonjë person tjetër që të ka
13 dhënë detyra.

14 PË. Vetëm Sali Veseli.

15 PY. Pra, nëse vinte ndonjë informacion i rëndësishëm, kur
16 ishe anëtar i drejtorisë operative, ti këtë informacion kujt
17 do ia përcillje, kujt do ia raportoje si rregull?

18 PË. Asnji raport, asnji informacion që ka dalë nga drejtoria
19 operative, gjatë kohës sa unë kam qenë, nuk ka dalë pa e
20 verifiku Sali Veseli dhe pa e nënshkru Sali Veseli. Ky ka qenë
21 rregull. Asnji dokument nuk është i nënshkruar nga unë që ka
22 dalë nga drejtoria operative. Për shkak se nuk kam pas të
23 drejtë me nënshkru dokumente që dalin nga drejtoria operative.
24 Ka qenë Sali Veseli. Ai ka qenë një oficer i shkëlqyeshëm dhe
25 shumë strikt.

1 PY. Pra, ju këtu po flisni për informacionin që dilte jashtë
2 drejtorisë. Unë jam i interesuar këtu kur ti mësoje një diçka
3 të rëndësishme, një informacion, brendapërbrenda drejtorisë,
4 me kë do e bisedoje këtë gjë, kujt do t'i drejtoheshe?

5 PË. Me Sali Veselin. Kur nuk ishte Sali Veseli me Bislim
6 Zyrapin. Na kemi qenë tre oficerë, tre ushtarakë, kemi qenë në
7 Shtabin e Përgjithshëm. Në atë kohë, flas për kohën sa unë kam
8 qenë -- më falni, më falni, të lutem. Po, po.

9 PY. Nuk ka problem, në rregull. Do flasim për diçka tjetër. A
10 keni njohur ndonjë anëtar të UÇK-së që njihej si Murrizi në
11 1998?

12 PË. Agim Zogaj ka qenë. Nji ushtar ka qenë ai, nji ushtar i
13 shkurt, i vogël, i zeshkët, dhe unë atë e kam njoft si
14 komandant Murrizi.

15 PY. Me sa keni ju dijeni, çfarë roli ka pasur ky person në
16 UÇK në 1998, në këtë periudhë?

17 PË. U ndaluan dy gazetarë serbë. Ishte rregull që gazetarët
18 të cilët nuk ishin të akreditum prej zyrës për informim të
19 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ziheshin nëpër territoret e
20 Kosovës, atëherë ata ndaloheshin. Rasti ka qenë me ato dy
21 gazetarë, nuk kanë qenë të akredituar për të qëndru në
22 territorin e Kosovës. I ka ndalu Shaban Dragaj dhe i ka sjellë
23 në Shtabin e Përgjithshëm.

24 Aty ata janë vendos, shtëpia e bardhë e ka pas nji
25 bodrum, dy dhoma, dhe ata janë vendos aty për nja më duket nja

1 10 ditë, a 15, nuk e di. Dhe Agim Zogaj ka qenë përgjegjës për
2 përkujdesjen për ta.

3 PY. Nga e dini ju që ka qenë Agim Zogaj për kujdesjen e tyre?

4 PË. Po ishim unë e Sali Veseli, më kujtohet duke hangër
5 mëngjes dhe erdh tha, "çka të baj unë për mëngjesin e këtyne
6 që janë aty?" E ndamë nga mëngjesi jonë, unë e Sali Veseli,
7 nga një pjesë, ia dhamë dy bataniqe dhe jua dërgoi atyne atje.
8 Dhe kështu unë mora vesh. Pastaj kam shku në detyrë që ju
9 thashë përpara, kur jam kthyer atëherë u liruen më 28 nëntor.
10 Pra, aty kanë ndejt diku një 14 ditë, 13, 14.

11 E di që ato dy dhoma pastaj janë përdor për stafin e
12 femrave që kanë qenë të punësuar në drejtori të Shtabit të
13 Përgjithshëm, janë ripunu ose si të them, dhe janë riadaptuar
14 për dhoma të tyre. Por nuk ka qenë burg aty, nuk është mbajtur
15 si burg, por dhoma fjetjeje.

16 PY. Sa i takon periudhës kohore, kur erdhi Agim Zogaj të
17 fliste me ty dhe Sali Veselin për këta gazetarët, a e kam
18 kuptuar unë drejt që kjo ngjarje ka ndodhur përafërsisht në
19 datën 15 nëntor kur ke shkuar ti atje, por përpara se të
20 largoheshe për të kryer detyrat që të kishte dhënë Zyrapi?

21 PË. Po. Mund të them që ka qenë dita e nesërme, 16 ose 17,
22 aty dikur, jo dita e parë. Ka qenë dita 16 mëngjes apo 17, nuk
23 jam shumë i sigurt se më 18 e di që kam shku në detyrë. Pra,
24 ka qenë ato ditë, jo dita e parë.

25 PY. A e dini Agim Zogaj, apo Murrizi, jetonte asokohe në

1 nëntor 1998 [Sipas përkthimit]?

2 PË. Nuk e ka pas shtëpinë shumë larg nga selia e Shtabit të
3 Përgjithshëm. Aty jetonte familja e tij.

4 PY. Keni shku ndonjëherë në shtëpi aty?

5 PË. Po, kam shku disa herë. Më kujtohet që gruaja e tij dhe
6 më duket nëna m'i kanë ndërru, m'i kanë la rrobat. Ndërresat,
7 e mia kur i ndërroja, ato i lajshin, i pastrojshin dhe e kam
8 hëngër një drekë aty. Më kujtohet si sot.

9 PY. Do të kaloj tani në diçka tjetër. Në intervistën që i
10 keni dhënë tribunalit TPNJ, keni thënë se kur ndodheshit në
11 Smolicë, kur patë prezantimin e zëdhënësit të UÇK-së, në atë,
12 në intervistën me ZPS-në ju thatë që ky zëdhënës ishte Jakup
13 Krasniqi. A mund të sqaroni se kur ka ndodhur që ju keni qenë
14 në Smolicë dhe keni parë apo keni marrë vesh që Jakup Krasniqi
15 ishte prezantu si zëdhënës i UÇK-së?

16 PË. Më kujtohet prezantimi i parë i z. Krasniqi për zëdhënës
17 të UÇK-së. Ishte një, një befasi -- jo befasi, por ishte një
18 gëzim i madh që po prezantohet në emër të UÇK-së një person me
19 emër, mbiemër, dhe i njohur. Pra, se përpara njifeshin me
20 nofka. Tash a ka qenë dikund pjesa e parë apo e dytë e
21 qershorit, nuk jam i sigurt. Por e di që ka qenë qershor 1998,
22 sipas kujtesës time, pra.

23 PY. A e keni parë ndonjëherë Jakup Krasniqin në Shtabin e
24 Përgjithshëm të UÇK-së kur keni shku aty në nëntor të 1998?

25 PË. Po, ai ka qenë tanë kohën në qatë, që i thojnim ne,

1 shtëpia e bardhë.

2 PY. Dua t'i kthehem tani asaj që thatë, lidhur me gazetarët
3 serbë. Përmendët se nuk ishin të akreditum, dhe përmendët një
4 zyrë për informim dhe komunikim të UÇK-së. Kush ishte
5 përgjegjës i asaj zyre kur ndodheshit ju vetë në Shtabin e
6 Përgjithshëm në nëntor të 1998?

7 PË. Z. Krasniqi ishte drejtor i drejtorisë për informim në
8 shtabin e përgjithshëm dhe ishin zyrat për informim. E kishim
9 në Prishtinë, ishte në Tiranë. Kishte zëdhënës në Gjenevë,
10 Bruksel, Vjenë, Berlin, Paris, Londër edhe Uashington. Z.
11 Krasniqi e ka pas, do të thotë, pozitën e tillë me i koordinue
12 të gjitha zyrat e informimit, do të thotë, edhe me bashkëpunu
13 me ta. Pra kjo ishte detyra parësore e z. Krasniqi në Shtabin
14 e Përgjithshëm, qysh unë e kam kuptu. Flas gjithmonë qysh unë
15 e kam kuptu.

16 PY. Me aq sa dini ju, roli i inspektorit të përgjithshëm të
17 UÇK-së çfarë përfshinte?

18 PË. Roli i inspektorit të përgjithshëm të UÇK-së, nuk di sa
19 ka arrit inspektori i përgjithshëm me e zhvillu sektorin e
20 vet. Ai ka pas detyrë që në, me i caktu inspektorët nëpër zona
21 operative e ndoshta edhe brigada, ata me ia propozu shefit të
22 shtabit, dhe me i emëru si inspektor, të cilët kishin me i
23 mbikëqyr do të thotë të gjitha aktivitetet e njësisë, pra
24 zonave operative, brigadave, nëpër krejt territorin e Kosovës,
25 me i identifiku parregullsitë të cilat ata mendojnë që janë,

1 me i raportue shefit të shtabit dhe me propozu masa për me
2 ndërmarrë që ato parregullsi ose mangësi me u përmirësu. Kjo
3 është ajo që unë e di çka duhet me bo, do të thotë, dhe çfarë
4 përgjegjësie ka inspektori i përgjithshëm i një ushtrie. A ka
5 arrit apo sa ka arrit inspektori i përgjithshëm me e zhvillu
6 këtë sektor, nuk jam në dijeni për shkak se unë, e dini, në
7 janar jam largu nga Shtabi i Përgjithshëm, kam shku në
8 Dukagjin.

9 PY. Në intervistën që i keni dhënë Zyrës së Prokurorisë së
10 Specializuar e keni përmendur Rexhep Selimin si inspektor të
11 Shtabit të Përgjithshëm dhe e keni përmendur si një prej
12 personave që kishte të drejtë që të merrte pjesë në seancat
13 informuese midis anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të
14 UÇK-së dhe komandantëve të zonave operative. A e keni parë
15 Rexhep Selimin në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së kur ju vetë
16 ishit aty në nëntor të 1998?

17 PË. Unë dua t'ju përmirësoj këtu dhe t'jua përkujtoj, z.
18 Prokuror, një të vërtetë që unë kurrë nuk e kam dit emrin e
19 vërtetë të Rexhep Selimit. E kam dit për Dhjetëshi. Pra, ashtu
20 e kam dit. Pra, e kam dit si Dhjetëshi, inspektori i
21 përgjithshëm i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare
22 të Kosovës. Normalisht se nga pozita që ka pas dhe funksioni
23 ka qenë edhe anëtar i shtabit, pra anëtar i ngushtë i Shtabit
24 të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

25 Dhe ju thoni për biseda informative. Unë i kam kuptu si

1 mbledhje të shtabit. Pra, mbledhje të shtabit. Se komandantët
2 e zonave kanë qenë anëtarë të barabartë të Shtabit të
3 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare, ai rrethi i ngushtë,
4 Shtabi i Përgjithshëm të Ushtrisë, ku merrshin pjesë
5 komandantët e zonave, drejtorët e drejtorive operative dhe të
6 drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm, shefi i shtabit,
7 inspektori i përgjithshëm, edhe shefi i drejtorisë për çështje
8 juridike apo siç themi ato, ajo. Dikush e ka qujt gjykata
9 ushtarake por brenda asaj drejtorie është ngrit gjykata
10 ushtarake. Këto kanë qenë mbledhje që janë mbajt një herë në
11 muaj.

12 PY. Kur e keni marrë vesh që personi që njëhej me emrin
13 Dhjetëshi gjatë luftës, që me këtë emër, pra, njëhej gjatë
14 luftës ishte në fakt Rexhep Selimi?

15 PË. E kam marrë vesh mbas luftës.

16 PY. Tani, të përgendrohemi edhe një herë në periudhën kur ju
17 keni qenë në Shtabin e Përgjithshëm duke filluar nga nëntori i
18 vitit 1998. A e keni parë një person të cilin asokohe e keni
19 njoft me emrin Dhjetëshi, në Shtabin e Përgjithshëm rreth
20 kësaj kohe?

21 PË. Po, e kam pa atë, besoj më kujtohet e kam pa disa herë
22 unë, që ka hy, ka dalë, do të thotë, aty. Por ndonjë komunikim
23 me mu nuk e ka pasur, si me hy në dhomën apo zyrën ku isha unë
24 në drejtori operative.

25 PY. Si e keni ditur, pra, si e keni marrë vesh që ky person

1 që ju e keni pa aty, ishte Dhjetëshi?

2 PË. Po të gjithë e dinim që ky është dhjetëshi. E dinte Sali
3 Veseli, e dinte Bislum Zyrapi, të gjithë e dinim që është
4 dhjetëshi.

5 PY. Po kaloj tani në një temë paksa tjetër. A keni shku
6 ndonjëherë në Divjakë [Sipas përkthimit] pasi jeni kyçur në
7 drejtorinë operative?

8 PË. Unë aty kam flejt edhe kam punu. Tanë kohën derisa s'jam
9 shku në Dukagjin.

10 PY. Të jemi të qartë, Turjakë, thashë Turjakë, jo Divjakë.

11 PË. Po, po. Mirë. Në Turjakë kam shku në q'atë periudhën nga
12 njizet e -- kur e mora detyrën parë, nga 18 deri më 27 nëntor.
13 Është hera e parë dhe e fundit gjatë luftës. Në përcjellje të
14 komandantit të brigadës Vesel Maliqit. Dhe në Turjakë
15 normalisht kam mbajtur, kemi mbajtur mbledhje si në çdo fshat
16 tjetër me njësitin e Turjakës edhe me fshatarët. Më duket ka
17 qenë dikund 23 ose 24 nëntor.

18 PY. A e keni njohur apo keni dëgjuar për Jakup Kastratin dhe
19 Cen Deskun?

20 PË. Për Jakup Kastratin dhe Cen Deskun kam pas dëgjuar kur
21 kam qenë i plagosur. Nji komunikatë që janë ndalu, ishte nji
22 komunikatë në emër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që janë
23 ndalu, edhe që mbahen dikund. Në Turjakë qëlloni puna që ne të
24 mbajmë atë mbledhje me fshatarët dhe njësitet e Turjakës. Ne
25 atje i thomi fshatrat në mëhallën, në lagjen e Kastratëve. Pra

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 67

1 në lagjen e Jakup Kastratit. Edhe më duket bash në odën e tij.

2 PY. Dëshmitar, për t'u sqaruar për përgjigje të paktën siç e
3 morëm në përkthim. Thatë se:

4 "Kam ndigju për ata kur jam plagosur, kishte një
5 komunikatë e cila ka dalë në emër të UÇK-së, sipas të cilës
6 unë më kishin mbajtur të ndaluar, pra të burgosur diku ..."

7 E keni fjalën për veten tuaj apo dikë tjetër?

8 PË. Jo, jo. Jo. Përkthimi ka qenë gabim. Komunikatë janë
9 ndalu, që janë ndalu Cen Desku dhe Jakup Kastrati.

10 PY. [Mikrofoni çaktivizuar].

11 Z. PACE: [Përkthim] Ndjesë.

12 PY. Ju lutem, t'u thoni Gjykatësve shumë shkurt nëse keni fol
13 për diçka në këtë takim që ju mendoni se mund të ketë ndodhur
14 në atë dhomën e vjetër të Jakup Kastratit?

15 PË. Unë si në çdo takim e kam prezentu komandantin e ardhshëm
16 të brigadës. Kam njoftu njësitin edhe qytetarët, edhe
17 fshatarët, përfaqësuesit e familjeve. Se thirrreshin
18 përfaqësuesit e familjeve në atë tubim, që ky do të jetë
19 komandanti i brigadës i ri, edhe jam përgjigj në pyetje që
20 kanë pas të pranishmit aty. Kam fol për UÇK-në, për që kemi me
21 u çlirë, që Kosova do çlirohet, që jem duke u zhvillu, duke u
22 ngrit si Ushtria Çlirimtare. Për sukseset, për të gjitha ato
23 që një ushtarak flet në kohën e luftës për të dhënë shpresë
24 qytetarëve, ushtarëve, për të dhënë shembuj ose për t'i josh
25 për të përkrah Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për t'u

1 mobilizu. Këto qysh janë zakonisht, që çdo ushtarak dhe çdo
2 oficer i bën me qytetarë dhe me ushtarë.

3 PY. Përmendët një takim apo tubim që mund të ketë ndodhur në
4 dhomën e vjetër të Jakup Krasniqit kur keni qenë aty rreth
5 kësaj kohe. A jeni taku me ndonjë prej anëtarëve të familjes?
6 PË. Po, sigurisht. Ata kanë qenë aty se ishte oda e tij. Po
7 ai kishte qenë një aktivist i atij fshati, shumë i njohur,
8 edhe me ndikim aty. Dhe zakonisht mbaheshin ato takime në odat
9 e njerëzve që ishin me ndikim në atë fshat ose lagje. Dhe ai
10 ishte me ndikim dhe sigurisht ka qenë familja e tij aty.

11 PY. Kur keni qenë aty në odë, familja e tij a kishte përmend
12 diçka me, që kishte të bënte me atë çka kishte ndodh më herët
13 për shembull me ndalimin e Jakup Kastratit, Cen Deskut?

14 PË. Po, më kujtohet mirë që e kisha pyetjen që a e dini se ku
15 janë, dhe si janë Jakup Kastrati edhe Cen Desku.

16 PY. Po ju si u jeni përgjigj?

17 PË. Para se të shkoja atje, mu më pat thanë Shaban Dragaj se
18 Shaban Dragaj ishte një familjar i lartë kah ana e babës me
19 Cen Deskun, edhe ai kishte ndëgjju që këta të dy do të lirohen
20 më 28 nëntor. Dhe unë ju thashë atyne të pranishmëve, bile më
21 kujtohet shumë mirë se ma kanë përmend pas lufte shumë herë sa
22 herë kam shku aty, se tash kemi edhe lidhje familjare se një
23 djalë i vllaut tim e ka gruan prej tyne. Ma kanë përmend
24 fjalinë që e kam thonë, që këtu në këtë odë kemi me hangër
25 drekë me Jakup Kastratin. Pra, me bindje të plotë që me i bind

- 1 që këtu në këtë odë kemi me dreku bashkë, me Jakup Kastratin.
2 Dhe ajo ka ndodh do të thotë më 28 nëntor, janë liru Cen Desku
3 edhe Jakup Kastrati.
- 4 PY. Po ndërroj temë. Në intervistën që i keni dhënë Zyrës së
5 Prokurorit të Specializuar thatë se kur keni qenë në
6 drejtorinë operative informacionet nga zonat operative vinin
7 përmes telefonave satelitorë. Me sa keni ju dijeni, veç një
8 apo më shumë se sa një telefon satelitor kishte në Shtabin e
9 Përgjithshëm të UÇK-së kur keni qenë ju aty vetë?
- 10 PË. Unë sa di, është dasht me pas telefon çdo drejtori e
11 Shtabit të Përgjithshëm, për shkak se ne kishim telefonin.
12 Drejtoria operative një telefon, shefi i shtabit e kishte një
13 telefon, dhe ju kam tregu kur më keni pyet se zakonisht kur
14 shefi i shtabit shkonte në terren, unë isha kujdestar te
15 telefoni i shefit të shtabit. Ka pas telefon patjetër që është
16 dasht të jetë zëdhënësi i UÇK-së. Ai e ka përdor ma së shumti
17 se ka pas me të gjitha qendrat e informimit që ju thashë
18 përpara që janë ngrit, edhe besoj kanë pas edhe drejtoritë e
19 tjera.
- 20 PY. Për t'u sqaruar, Dëshmitari thotë që "kur më kanë pyet",
21 u duk sikur ishte për ju, por besoj se e kishit fjalën për
22 seancën përgatitore që e kemi bërë bashkë javën që shkoi?
- 23 PË. Po.
- 24 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj që të
25 kalojmë në seancë private për shkak të kufizimeve për

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 70

1 dokumentin që do të përdor pas pak. Besoj se nja dhjetë minuta
2 do jemi në seancë të mbyllur.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
4 seancë private për të mbrojtur burimin e materialit.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 71

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 72

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 73

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 74

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 jemi në seancë publike.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Maloku, do
12 bëjmë një pushim dhjetë minuta tani. Mund të dilni nga salla
13 me Shoqëruesen e sallës.

14 DËSHMITARI: Faleminderit.

15 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu
17 ndërprerjen e seancës për dhjetë minuta.

18 --- Pauza fillon në orën 15.27

19 --- Seanca rifillon në orën 15.39

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, sot
21 duhet të përfundojmë se Mbrojtja e Selimit do të bëjë një
22 deklaratë, më saktë desha të thoja që sot do përfundojmë në
23 orën 4.25 dhe jo në orën 4.30.

24 Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

25 Z. PACE: [Përkthim] A mund të më thoni për çfarë do jetë

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 75

1 kjo deklaratë, a duhet të jemi ne të pranishëm, apo jo?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, po. Duhet
3 të jeni dhe ju se ka të bëjë me dëshmitarin e javës tjetër.

4 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në fakt, kishim thjesht një
6 propozim konstruktiv, nëse më lejoni ta përkufizojë kështu, që
7 dua ta ngre me Trupin Gjykses.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më pëlqejnë
9 shumë sugjerimet konstruktive. Se nuk marrim shumë prej jush.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
12 z. Maloku, do vazhdojë Prokuroria me pyetjet.

13 Vazhdoni, z. Pace.

14 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Ndërkohë mund ta heqim
15 dokumentin nga ekrani dhe të vendosim në ekran një faqe nga
16 libri i dëshmitarit që ka numër U002-3041-U002-3143 përbri dhe
17 anglishten që ka numrin U002-3080-U002-3141-ET. Në të dyja
18 variantet do të doja të shkonim në fagen U002-3103, në shqip
19 është faqja 63 e PDF-së, në anglisht është faqja 24. Ju kërkoj
20 ndjesë, 62 tek shqipja. Ndërsa anglishtja është në rregull.
21 Faleminderit.

22 PY. Dëshmitar, në të majtë është një faqe nga libri juaj.

23 Z. PACE: [Përkthim] Në shqip, zmadhojeni pak ju lutem që
24 të shohim tri paragrafët e fundit në të majtë. Këtu. Do filloj
25 të lexoj tek anglishtja pjesën përkuese unë.

1 Zmadhojeni dhe anglishten aty ku duket numri 122. Po

2 lexoj këtu ku thotë "Para Rambujesë ..."

3 PY. Dëshmitar, ose ndiqeni përmes përkthimit me gojë ose
4 shikojeni vetë tek libri në shqip. Po lexoj diçka dhe pastaj
5 do t'ju bëj pyetje.

6 "Para Rambujesë, ndodhi Reçaku, ndodhi zënia rob e tetë
7 ushtarëve jugosllavë në Shalë, ndodhën bisedimet për lirimin e
8 tyre në Dragobil dhe në Drenicë.

9 "Çka ishte e rëndësishme nga bisedimet në Dragobil?

10 "Ne para faktorit ndërkombëtar u legjitimuam se jemi
11 strukturë e rregullt ushtarake, se kemi subordinim se ushtarë
12 ishin zënë në Shalë nga një njësi e një brigade, ndërsa
13 bisedimet për lirimin e tyre zhvilloheshin në Shtabin e
14 Përgjithshëm në Dragobil."

15 Po ndaloj për momentin këtu. Besoj se ju e keni përmendur
16 edhe sot këtë ngjarje në fakt --

17 PË. Po, po

18 PY. -- por unë kam këtë pyetje.

19 PË. Po.

20 PY. Pyetja ime është kjo: Nga e dini ju se diskutimet për
21 lirimin e ushtarëve janë bërë në Dragobil dhe në Drenicë?

22 PË. Po unë isha qatë. Do të thotë, isha në shtab, në Shtabit
23 të Përgjithshëm, drejtori operative. Çka në bisedime shkonte,
24 shkonte 11-shi, që ishte, ishte i caktuar për takime me
25 faktorin ndërkombëtar. Shkojke Bislim Zyrapë dhe shkojshin,

1 shkojke shefi i shtabit dhe anëtarë tjerë. Pra dhe këtëjna ne
2 e dijsim që po ndodhnin bisedimet se bëhej ndërrimi i
3 ushtarëve të zënë rob nga Zona Operative e Shalës me disa
4 ushtarë që ne i kishim kap në muajin dhjetor kur një kolonë e
5 ushtarëve tanë ranë në pritë dhe shumë u vranë por disa u
6 zunë. E pra, ishte kjo ndërrimi, ndërrimi i ushtarëve me
7 ndërmjetësimin e personave të misionit vëzhgues ndërkombëtar
8 aty dhe ne e dinim që po ndodhnin këto. Edhe mediat edhe
9 mediat e prezantojshin ato, ato kontakte dhe takime. Pra, nuk
10 kishte gjë që nuk e dijsin edhe populli. Po.

11 PY. A mund ta sqaroni në cilin muaj e vit ka ndodhur ky
12 incident?

13 PË. Po diku në -- Mujë Krasniqi edhe do tjerë kanë ra dikur
14 ka 14 dhjetori. E bisedimet për këmbimin me ushtarë diku janë
15 mbajt dhjetor, janar më duket. S'jam -- qaty dikund do të
16 thotë. Po. Po.

17 PY. Në përgjigjen tuaj përmendët 11-shin. A mund të na e
18 thoni emrin dhe mbiemrin e këtij personi?

19 PË. Mbas lufte e kam kuptu Sokol Bashota është. Po, po.

20 Z. PACE: [Përkthim] Do vazhdoj të lexoj nga pjesa ku e
21 lashë, më duket se tek shqipja është rreshti i fundit kështu
22 që duhet të kalojmë në faqen tjetër pasi të përfundoj fjalinë.

23 PY. "Ishte dhe një rast tjetër që duhet të përmendet. Në
24 muajin janar, kur u rrethua një grup prej dhjetë ushtarëve të
25 Shalës së Bajgorës në një paralagje të Mitrovicës nga forcat

1 serbe, përmes verifikuesve të OSBE-së kërkohej nga Shtabi i
2 Përgjithshëm i UÇK-së që t'u jepej urdhër atyre të
3 dorëzoheshin për 15 minuta. Por, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-
4 së dha urdhër që ata të mos dorëzoheshin dhe dërgoi ndihmë
5 njësinë speciale të Drenicës dhe njësi të Shalës për t'i
6 nxjerrë ata nga rrethimi. U vra një ushtar i yni, u plagos një
7 tjetër, po në mbrëmje ata nxorën nga rrethimi. Serbëve u
8 shkaktuan dëme shumë të mëdha në njerëz dhe teknikë.

9 "Këto dy momente faktorit ndërkombëtar i jepnin të
10 kuptonte se jemi ushtri e organizuar dhe si ushtari i fundit
11 në atë strukturë i dëgjon urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm."

12 Dëshmitar, unë kam këtë pyetje tani: Nga e dini ju për
13 këtë urdhrin e janarit të Shtabit të Përgjithshëm për të mos u
14 dorëzuar dhe se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka dërguar
15 njësinë speciale të Drenicës dhe njësi nga Shala, nga e dini
16 ju këtë?

17 PË. Po ky, ky operacion u zhvillu në drejtorinë operative. Ne
18 e kishim një radiostacion që i përgjonim forcat policore
19 ushtarake serbe dhe e dinim se në çfarë korridori muj me ju
20 ardhë në ndihmë ushtarëve tanë atje.

21 Forcat serbe kërkuan përmes përfaqësuesve të OSBE-së që
22 ata të dorëzohen dhe përfaqësuesit e OSBE-së dhanë garancione
23 që trajtimi i tyre do të bëhej në bazë të konventave,
24 konventave ndërkombëtare. Po na s'mujshim me ju besu serbëve.
25 Edhe po që ata të dorëzohen, këtu thotë për 15 minuta, ata

1 kanë pritë gati dy ditë për me, për me u dorëzu ushtarët tanë.
2 Nuk a vetëm urdhri se ata nuk ke mujt na me dhënë urdhër me u
3 dorëzu, ata vetë nuk kanë dasht me u dorëzu. Pra, s'kemi mujt
4 na urdhën me dhënë. Ata s'kanë dasht vetë me u dorëzu.

5 E kem dit në bazë të përgjimeve se cila, se cili korridor
6 dhe kah muj me ju shku ndihmë dhe i keni dërgu njësinë
7 speciale, më kujtohet si sot, të Brigadës 111, kemi dërgu
8 mbështetje pas shpine njësisë speciale të Shalës edhe janë
9 nxjerrë, janë nxjerrë ushtarët nga aty. Një na u ka vra edhe
10 më duket një është plagosë. Ata kanë pas humbje. E dinë vetë
11 sa.

12 Pra, unë këtu veç e kam, e kam tregu si shembull se para
13 vëzhguesve ndërkombëtarë se ata ishin ardh, ishin ardh me
14 rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkume. Ata
15 këtë punë kishin të vëzhgojnë dhe të monitorojnë dhe të
16 raportojnë për nivelin organizativ të Ushtrisë Çlirimtare të
17 Kosovës. Unë për atë thashë, këtu e kam ekzagjeru pak, jo
18 shumë, nuk është punë subordinimi i strikt, por është respektu
19 Shtabi i Përgjithshëm. Pra, Shtabi i Përgjithshëm është
20 respektu edhe kjo, kjo është me rëndësi.

21 Na e kemi fitu vendin në tavolinë në Rambuje për shkak
22 qëtyne sjelljeve tona dhe për shkak edhe të vlerësimeve që i
23 kanë dhënë misioni vëzhgues ndërkombëtar për neve. Nuk e kemi
24 fitu ne atë vend aty palë bisedime me palën kundërshtare kur
25 tanë kohën na quajshin terrorista. Për pa pas vlerësime për

1 neve që jemi një ushtri. Po them edhe një herë, ushtri e
2 organizume vullnetare. Vullnetare.
3 PY. Dëshmitar, në këtë fragment thuhet diçka dhe ju thatë që
4 është pasqyruar në fakt saktë se "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-
5 së dërgoi njësitin special të Drenicës dhe njësitet të Shalës".
6 Kjo pjesë a është e saktë? Domethënë, Shtabi i Përgjithshëm i
7 UÇK-së a dërgoi njësitin special të Drenicës dhe njësi të
8 Shalës në ndihmë të këtyre ushtarëve?

9 PË. Unë këtu vetëm, vetëm një ndryshim këtu një e kam bërë për
10 shkak se libri ka qenë për opinionin e gjyrit. Z. Prokuror,
11 Shtabi i Përgjithshëm nuk ka rol komandues. Operacionin e ka
12 kry drejtoria operative e Shtabit të Përgjithshëm dhe nën
13 drejtimin e shefit të shtabit. Nuk ka të bëjë, për shembull,
14 drejtori i drejtorisë për informim me operacionin e tërheqjes
15 nga rrethimi të dhjetë ushtarëve tanë në zonën, në një
16 paralagje të Mitrovicës ose operacionin tjetër të cilin unë
17 vetë e kam udhëhequr në një paralagje të Podujevës. Këto i ka bërë
18 drejtoria operative e Shtabit të Përgjithshëm edhe shefi i
19 shtabit.

20 PY. A e konfirmoni ose më korrigjoni po s'e kam kuptuar. Unë
21 e kuptoj kështu, ju po thoni që drejtoria operative e Shtabit
22 të Përgjithshëm dhe shefi i shtabit ishin dy organet po themi
23 apo organet kompetente që dërguan njësitin special të Drenicës
24 dhe të Shalës në këtë rast, pra këto dy njësi?

25 PË. Po, kjo ishte punë e jona. Po ishim në luftë na. Nuk u

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 81

1 gjujshim me bombona aty po.

2 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull. Kalojmë në seancë private
3 për të njëjtat arsye si më herët për të mbrojtur dokumentin.
4 Dhe do na duhet të qëndrojmë në seancë private për pjesën e
5 mbetur të ditës.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
7 seancë private që të mbrojmë burimin e materialit.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 82

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë private)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 85

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, z.

25 Pace.

1 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

2 PY. Dëshmitar, tani do flasim për një temë tjetër. Në
3 intervistën për ZPS-në, ju thatë se gjatë janarit të 1999, në
4 një takim të janarit 1999, Ramush Haradinaj, komandanti i
5 Dukagjinit, kërkoi që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së t'ju
6 caktonte ju që të ndihmonit Zonën Operative të Dukagjinit, nuk
7 ju kujtohej saktësisht data kur shkuat nga Shtabi i
8 Përgjithshëm i UÇK-së në Dukagjin, saktë?

9 PË. Po, mund me qenë pjesa e dytë janarit, pasi që këto që i
10 pamë këto dokumenta flitshin me për 17 janar. Unë kam qenë
11 kujdestar në Shtabit të Përgjithshëm si duket, kështu siç
12 është këtu.

13 PY. Ta kemi të qartë, Dëshmitar, kur thoni "dokumenti që
14 pamë" e keni fjalën për seancën përgatitore javën e kaluar?

15 PË. Po.

16 Z. PACE: [Përkthim] Tani do kërkoja të vendosej në ekran
17 materiali me numër SPOE00226468-SPOE00226480 përbri edhe
18 përkthimi në gjuhën angleze që mban numrin SPOE00226468-
19 SPOE00226480-ET *Revised* dhe të shohim faqen që përfundon me
20 numër 226473 në të dyja versionet.

21 PY. Dëshmitar, në të majtë të ekranit është një dokument në
22 shqip me shkrim dore, në të djathtë është përkthimi në
23 anglisht. Dokumentin në të majtë që ekranit përpara se t'ua
24 tregoja unë javën e kaluar, a e kishit parë ndonjëherë?

25 PË. Jo, Prokuror.

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 87

1 PY. Shohim datën 21 janar 1999 në tekst dhe në krye thuhet

2 "Rendi i ditës" dhe më pas:

3 "Informacion rreth takimit me komandantët e zonave
4 operative."

5 Z. PACE: [Përkthim] Tani do shkoja, do donim të shkonim
6 në faqen tjetër, të lutem, të materialit dhe tek anglishtja
7 dhe tek shqipja. Në krye, në krye të faqes thuhet:

8 "Të transferohet Naim Maloku në Dukagjin për asistencë."

9 Dëshmitar, a ju kujtohet edhe ju kështu ngjarja që të
10 keni shkuar në Dukagjin përafërsisht rreth 21 janarit të 1999,
11 pas kësaj date?

12 PË. Po.

13 PY. Poshtë kësaj thuhet:

14 "Të transferohet Shaban Draga në Drenicë."

15 A ju kujtohet nëse u transferua vërtetë Shaban Draga në
16 Drenicë?

17 PË. Jemi transferu të njëjtën ditë. Jemi përshëndet me Shaban
18 Dragën. Ai ka shku në Drenicë nga Brigada 121 e Zonës
19 Operative të Pashtrikut ka shku në Zonën 1 të Drenicës, po nuk
20 e di në cilën brigadë ose për çfarë detyre ka shku atje.

21 PY. Në të njëjtën faqe, në rreshtin e pestë përmendet Plaku.
22 A e dini kush është?

23 PË. Unë mbas lufte e kam kuptu që është Xheladin Gashi ka
24 qenë, po. Nëse në këtë, në këtë qysh themi shënim ose
25 procesverbal është fol për të. Nëse nuk ka pas edhe ndonjë,

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 88

1 ndonjë person tjetër me pseudonimin Plaku.

2 PY. Shënimi këtu thuhet që:

3 "Të zëvendësohet Plaku, të ndërrohet Plaku në logjistikë
4 të caktohet një person tjetër."

5 A e dini nëse, z. Gashi, që njihej me emrin Plaku kishte
6 të bënte me logjistikën në UÇK?

7 PË. Po. Që është fjala për atë që unë e kuptoj, ai ka qenë i
8 pari i logjistikës në një drejtim, do të thotë, më duket nga
9 Kukësi apo Pashtriku këtej, se kemi pas një drejtim nga Bajram
10 Curri. Do të thotë, kemi pas disa, disa pika dhe shumë kanale
11 furnizime në të cilat kemi depërtu. Pra, Plaku ka pas
12 kontrollin ka Pashtriku e Kukësi, ndërsa në Bajram Curr ka
13 qenë qerim Kelmendi edhe Ilir Konushevci derisa u ka vra. Po.

14 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që këto
15 dy faqe që i treguam tani të pranohet në prova gjyqësore me
16 numrat SPOE00226473 dhe 226474.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
18 kundërshtim?

19 Atëherë duke qenë se s'ka kundërshtim, dokumenti numër
20 SPOE00226473 dhe 226474 pranohen në prova gjyqësore.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
22 marrin numrin e provës gjyqësore me numër P02095. Ju lutem të
23 konfirmojmë klasifikimin.

24 Z. PACE: [Përkthim] Publik.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

1 Riklasifikohen si publik.

2 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument nga
3 ekrani.

4 PY. Dëshmitar, gjatë seancës përgatitore që kemi bërë bashkë
5 keni thënë se pas mbledhjes së Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
6 së ku Ramush Haradinaj bëri kërkesa për transferimin tuaj, ju
7 kanë thirrur në zyrën e Jakup Krasniqi ku ishte i pranishëm
8 dhe Ramush Haradinaj. Ju kanë informu për kërkesën dhe ju
9 jeni pajtu me transferimin.

10 PË. Po.

11 PY. Pastaj thatë që, një moment të mëvonshëm, Jakup Krasniqi
12 ka dhënë urdhrin për transferimin, a është kështu?

13 PË. Po.

14 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj të nxjerrim tani në ekran
15 dokumentin me numër SPOE00228819 deri në SPOE00228819 krah për
16 krahë me përkthimin në anglisht që ka të njëjtin numër
17 elektronik me shtojcën -ET në fund. Faleminderit, znj.
18 Sekretare.

19 PY. Dëshmitar dhe një herë kemi një dokument majtas në
20 versionin shqip, djathtas në versionin anglisht. Dokumenti në
21 shqip, majtas, është ai që keni marrë nga Jakup Krasniqi?

22 PË. Po.

23 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë që ky
24 dokument të pranohet në prova gjyqësore.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 90

1 kundërshtim?

2 DËSHMITARI: A bën vetëm një sqarim të vogël?

3 Z. PACE: [Përkthim]

4 PY. Po.

5 PË. Z. Jakup Krasniqi, këtë pozitën sekondare si
6 zëvendëskomandant, sipas njohurive të mia, e ka kry për dy
7 muaj, muajin dhjetor edhe janar derisa nuk është, nuk është
8 caktu për me shku në Rambuje. Përndryshe detyra e tij kryesore
9 ka qenë, ajo bazike, zëdhënësi i UÇK-së edhe shef i drejtorisë
10 për informim.

11 Këtë pozitë është dasht me e marrë dikush për shkak të
12 rregullave procedurale që është dasht të plotësohet një pozitë
13 e tillë. Unë muj me jua spjegu nëse ju, nëse ju më lejoni
14 sepse u dasht me qenë një pozitë e tillë. A më lejoni me e
15 spjegu? Një minutë. Po?

16 PY. Jo.

17 PË. Po.

18 PY. Ajo dëshiroj që të sqaroni është që kur e thoni për
19 rregulloren, rregullat e procedurës, pra, rregulloren, për
20 cilën rregullore e keni fjalën?

21 PË. Jo. Është rregull, rregull procedural në ushtri që për të
22 vendosë, për shembull, për komandanta të zonave operative
23 duhet me qenë një pozitë ma e lartë sesa shefi i shtabit. Pra,
24 pozita e dytë edhe ne nuk kemi pas, Ushtria Çlirimtare e
25 Kosovës nuk ka qenë institucionale që me pas na komandantin e

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 91

1 përgjithshëm dhe presidentin për me emnu dhe shkarku

2 komandantë të zonave dhe operative.

3 Është dasht me e mendu një pozitë e cila është mbi shefin
4 e shtabit për shkak të qësaj procedure me e plotësu këtë
5 rregull që komandantin e zonës e propozon shefi i shtabit dhe
6 e emënon një pozitë më e lartë. Është në të gjitha ushtritë
7 kështu. Komandantin e brigadës e propozon komandant i zonës, e
8 emnon shefi i shtabit. Këtë rregullore e ka, e ka zbatu vetëm
9 Zona Operative e Llapit. E Dukagjinit nuk ka, nuk a lodh për
10 atë punë hiç. Qështu.

11 Qët funksion, këtë u dasht me pas edhe për me më
12 transferu mu nga Shtabi i Përgjithshëm si oficer i lartë në
13 Zonën Operative të Dukagjinit, u dasht një pozitë më e lartë
14 sesa shefi i shtabit. Po vetëm këtë funksion e ka luajt, e ka
15 plotësu z. Jakup Krasniqi për ndryshe ky ka qenë shef i
16 drejtorisë informative dhe zëdhënës i UÇK-së. Po.

17 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj ndjesë se
18 e ndërpreva procedurën për pranimin në provat gjyqësore.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
20 kundërshtim? Nuk ka.

21 Atëherë dokumenti me numër SPOE00228891 deri në
22 SPOE00228819, me të njëjtin numër dhe në anglisht pranohet në
23 provat gjyqësore.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo merr numrin e
25 provës P02096. Me çfarë klasifikimi?

1 Z. PACE: [Përkthim] Publik.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
3 Faleminderit. Mund të ricaktohet si publik.

4 Z. PACE: [Përkthim] Atëherë mund të mbajmë të njëjtin
5 dokument në ekran, po ju lutem të kalojmë tek pika 5 si në
6 anglisht ashtu edhe në shqip.

7 PY. Dëshmitar, është i njëjti dokument për të cilin po
8 flisnim. Siç e shihni në gjuhën shqipe thuhet në pikën 5:

9 "Masat e sigurisë dhe vetëmbrojtjes i vlerëson vetë
10 eprori sipas rrethanave luftarake duke kërkuar ndihmë në rast
11 nevoje nga komandanti i zonës sipas rastit."

12 Pyetje, Dëshmitar, pasi keni shku në Zonën Operative të
13 Dukagjinit pas kësaj urdhërese a keni bërë juve vetë një
14 vlerësim të rrethanave - më falni - të masave të sigurisë dhe
15 vetëmbrojtjes në bazë të rrethanave luftarake?

16 PË. Pika 5 është, është konform rregullave ushtarake kur
17 dërgohet një oficer i lartë nga një pozitë në tjetrën, atëherë
18 edhe në gjendje lufte, masat për vetëmbrojtje, do të thotë
19 duhet me i vlerësu vetë personi. Normalisht që nënshkruesi i
20 këtij dokumenti dhe këtij urdhni e ka heq përgjegjësinë prej
21 vetes, prej vetes nëse mu më cenohet siguria. Po duhet me i
22 vlerësu vetë, vetë masat e sigurisë dhe vetëmbrojtëses. Dhe
23 nëse ato i vlerësoj që unë rrezikohem me kërku, me kërku nga
24 Zona Operative e Dukagjinit. Është krejt në rregull kjo këtu
25 duke u përmbajtur rregullave ushtarake.

1 PY. E keni zbatu ju pikën 5 në praktikë, pra, kur keni shku
2 në Zonën Operative të Dukagjinit?

3 PË. Po me ju tregu të drejtën, unë ju kam besu të gjithë
4 ushtarëve, kën ma ka dhënë komandanti i Zonës Operative të
5 Dukagjinit me më shoqëru kur kam shku nëpër terren atë e kam
6 marrë. Nuk e kam pas ndonjë, ndonjë dyshim ose ndonjë tentim
7 për me bë vlerësimin për ta të përshtatshmërisë apo
8 besueshmërisë të njerëzve që kanë qenë rreth meje në uniformë
9 të UÇK-së.

10 PY. A keni kryer ndonjë lloj inspektimi sa u takon trupave
11 kur keni shku në Zonën Operative të Dukagjinit?

12 PË. Tanë kohën kam qenë nëpër vija, vija të jashtme të
13 territoreve të lira që ishin në atë kohë. Edhe tanë kohën i
14 kam inspektu dhe kontrollu njësitet vartëse të Zonës Operative
15 të Dukagjinit brigadave. Pra, unë jam ndoshta i vetmi që kam
16 kalue si oficer i lartë në Brigadën 133 edhe 136. Sa e kam, sa
17 di unë komandanti i zonës kurrë s'ka qenë në ato dy brigada.
18 Unë kam qenë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument nga
20 ekrani.

21 PY. Dëshmitar, gjatë kohës që keni kaluar në Dukagjin të
22 vitit 1999, a ju kujtohet se kush ka qenë komandanti i
23 Brigadës 131?

24 PË. Ka qenë Daut Haradini.

25 PY. Po për Brigadën 132?

1 PË. Sa kujtoj unë, Maliq Ndrecaj.

2 PY. Po për Brigadën 133 asokohe?

3 PË. Azem Veseli.

4 PY. A ju kujtohet dikush me emrin Naser Shatri?

5 PË. Naser Shatri ka qenë në kuadër të Brigadës 133, po s'më
6 kujtohet a ka qenë komandant i njësisë së policisë ushtarake
7 atje apo i një njësie speciale brenda Brigadës 133. Të gjitha
8 brigadat në kuadër në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës kanë pas
9 në kuadrin e vet njësi, njësi për veprim të shpejtë apo njësi
10 që i quanim ne njësi speciale.

11 PY. Kush ishte komandant i Brigadës 134 kur keni qenë ju atje
12 në vitin 1999?

13 PË. Është vra komandanti i brigadës në janar kur jam shku
14 unë, mbas pesë ditëve, komandanti i brigadës. Pastaj edhe disa
15 tjerë, disa tjerë të brigadës kanë dalë me i përcjellë të
16 plagosurit se më nuk kishim spitale ushtarake për trajtim
17 sekondar dhe terciar. Duhesh me i transportu jashtë shtetit.

18 Dhe unë kam fillu me e ngrit brigadën, me e ringrit
19 Brigadë 134 në Ratishë të Ulët. E kam fillu me tetë ushtarë.
20 Komandant brigade e kam propozue Ismet Ahmetin të cilin e ka
21 emnu, e ka aprovu dhe emnu Ramush Haradini.

22 PY. Na thoni ju lutem emrin e komandantit të brigadës përpara
23 Ismet Ahmetit, ai që thatë vdiq?

24 PË. Agron Rama ka qenë.

25 PY. Kush ishte komandant i Brigadës 136 kur keni qenë ju në

1 zonën e Dukagjinit në vitin 1999?

2 PË. Ka qenë Florim Krasniqi -- Florim Çela, më fal. Florim
3 Çela, oficer me akademi ushtarake të kryme këmbësori në
4 Beograd.

5 PY. Me aq sa dini ju, a ksihte ndonjë problem lidhur me këtë
6 brigadë kur keni qenë ju aty në vitin 1999?

7 PË. Ka qenë një divergjencë mes Rugova që janë 12 fshatra mbi
8 Pejë, malet e Rugovës. Ka pas një divergjencë. Ka qenë Ismajl
9 Hajdaraj me një grup ushtarësh si komandant i një pjese.
10 Ndërsa pjesën më të madhe e ka pas Brigada 136. Shef i shtabit
11 ka qenë Sali Lajçi. Edhe unë kam qëndru atje nja shtatë ditë
12 më duket. Po.

13 PY. A e njihni Ramiz Buriqin - siç u dëgjua?

14 PË. Po. Ramizi ka qenë me Smajl Hajdarin. Po.

15 PY. Ramiz Muriqi --

16 PË. Muriqi.

17 PY. -- është i njëjti person që --

18 PË. Po, po. Po i njëjti është.

19 PY. A ka pasur ndonjë moment kur ky person nuk ishte më i
20 përfshirë në Brigadën 136?

21 PË. Po. Ramiz Muriqi ka dalë pastaj në Shqipëri dhe më deri
22 mbas luftës nuk e kam pa.

23 PY. Me aq sa dini ju, a e dini nëse Ramiz Muriqi ishte i
24 lidhur me LDK-në apo me FARKU-n?

25 PË. Është fol shumë për FARKU-n, por ne ushtarakët nuk kemi

1 pas dallime. Ne jemi marrë vesh gjithmonë bashkë. Edhe qëllimi
2 ynë ka qenë në cilëndo rrugë të hyjmë në Kosovë për me dhënë
3 kontributin tonë për çlirimin e Kosovës, për shkak se kemi pa
4 probleme të mëdha që kanë ndodhë në Kroaci a ma së shumti në
5 Bosnje kur janë krijuar shumë ushtri dhe shumë linja
6 komandimi. Pra, ne ju kemi frigu gjithmonë krijimit të dy
7 ushtrive, tri -- të ushtrive të ndryshme dhe me linja të
8 komandimit të ndryshme. Ne jemi mundu me çdo kusht që mos me
9 pas, mos me pas divergjenca aq të madhe sa që me ardh deri
10 ndonjë konflikt, konflikt i armatosur. Ka pas vetëm fërkime
11 politike, fatmirësisht.

12 PY. Kush ishte komandant i Brigadës 138 kur keni qenë ju në
13 Dukagjin në vitin 1999?

14 PË. Kam shku më 8 maj 1999 në Dukagjin në Brigadën 138,
15 Rustem Berisha ka qenë. Kam shku me urdhën të Bislím Zyrapit.
16 Urdhni m'u ka dhënë me telefon. Po.

17 PY. Çfarë urdhri ju ka dhënë kur ishit aty me bë çfarë?

18 PY. Kam qenë në Brigadën 133 që e ka pas shtabin në
19 Studenicë. Kam marrë telefonatë diku mbas 17 -- dikun nga 17
20 prilli edhe më është thënë "Merre Gëzim Ostrenin, Ostenin shko
21 në Brigadën 136, merre Nusret Krasniqin me pseudonimin Hansi
22 edhe shko bashkangjit, bashkangjitju Brigadës 133 - 138", që e
23 komandonte Rustem Berisha, "se edhe unë po dal në Shqipëri
24 për me udhëheq me Operacionin Shigjeta". Ky ka qenë urdhni.

25 Z. PACE: [Përkthim] Kam dhe dy pyetje të shkurtra për ta

Dëshmitari: Naim Maloku (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 97

1 mbyllur këtë temë dhe pastaj mund ta mbyllim për sot. Do bëj
2 çmos.

3 PY. Dëshmitar, ku ndodhej komandanti, pra, ku e kishte
4 qendrën komandanti i Brigadës 138 kur ishit ju atje?

5 PË. Komanda e Brigadës 138 ka qenë në fshatin Papaj në
6 Shqipëri. Ndërsa krejt brigada ka qenë brenda territorit të
7 Kosovës. Linjat e frontit kanë qenë brenda territorit të
8 Kosovës.

9 PY. Shkurtimisht, e thënë shkurt, cila ishte arsyeja që
10 ndodhej në Shqipëri, pse komanda ndodhej në Shqipëri?

11 PË. Pse ishte më e sigurtë.

12 PY. Faleminderit.

13 Z. PACE: [Përkthim] Z. Gjykatës, këtu mund ta mbyllim për
14 sot.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. Maloku, për sot kemi përfunduar.

17 DËSHMITARI: Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
19 rikthehem nesër në orën 9.00.

20 DËSHMITARI: Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem mos
22 flisni me askënd për ato çka keni biseduar këtu jashtë kësaj
23 salle. Nëse dikush ju afrohet e ju pyet, na informoni.

24 DËSHMITARI: Faleminderit.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani mund të

1 dilni nga salla.

2 DËSHMITARI: Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalofshi mirë
4 sonte në mbrëmje.

5 DËSHMITARI: Faleminderit.

6 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

7 Z. PACE: [Përkthim] Me lejen tuaj duke qenë se kjo
8 çështje ka të bëjë me një dëshmitar tjetër, diskutimeve do t'u
9 përgjigjet kolegu im, z. Halling.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Ju lutem, të kalojmë në seancë
11 private.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
13 Sekretare, kalojmë në seancë private, ju lutem.

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
5 jemi në seancë publike.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë këtu
7 ndërprerjen e seancës deri nesër në orën 9.00.

8 --- Seanca mbyllet në orën 16.30

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25